



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 427 Akti

Nr. 435 Vendimi
Tiranë, më 9.9.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datat 7.9.2021 dhe 9.9.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arben Dyla**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Arben Dyla, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 9.9.2021 kërkoi kërkoi riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pastërtisë së figurës dhe atë të aftësive profesionale, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Arben Dyla është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” është zhvilluar shorti në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Arben Dyla do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Firdes Shuli dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

3. Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP) sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 24.12.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Arben Dyla, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Nëpërmjet postës elektronike, në datën 29.1.2020, subjekti deklaroi mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 30.6.2021, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, duke vlerësuar se provat e administruara për këtë kriter deri në këtë fazë të procesit të rivlerësimit, kishin nivelin e provueshmërisë sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

6. Në datën 1.7.2021, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, jo më vonë se data 12.7.2021; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 12.7.2021, përfaqësuesja ligjore e subjektit av. A. S. me nr. *** licence, NIPT ***, e caktuar sipas prokurës së posaçme nr. ***, datë 12.7.2021, paraqiti një kërkesë përmes postës elektronike, nëpërmjet së cilës kërkoi zgjatjen me dy javë të afatit të paraqitjes së provave dhe prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit për shkak të pamundësisë objektive të administrimit të dokumentacionit për përgatitjen e parashtrimeve, pritjen e një aktekspertimi kontabël nga një auditues i pavarur dhe përgatitjen e mbrojtjes nga ana e saj.

8. Me vendimin nr. 3, datë 13.7.2021, Komisioni pavarësisht se nuk gjeti arsye të qenësishme që të justifikojnë kërkesën e subjektit, nisur nga e drejta ligjore e përfaqësimit nga një përfaqësues ligjor, vendosi të shtyjë afatin për dërgimin e përgjigjeve deri në datën 20.7.2021 dhe zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 21.7.2021, duke arsyetuar se: (i) subjekti nuk ka shfrytëzuar afatin 12-ditor të caktuar nga Komisioni për të marrë në dorëzim aktet e dosjes pranë Komisionit; (ii) përfaqësuesi ligjor është caktuar ditën e fundit të afatit të dorëzimit të parashtrimeve; (iii) barra e provës deri në këtë fazë të hetimit administrativ i është kaluar vetëm për kriterin pasuror dhe se analiza financiare në pjesën dërrmuese i përket vetëm një pasurie; (iv) nuk është paraqitur asnjë dokument shkresor për të vërtetuar kërkimin e provave me qëllim paraqitjen e parashtrimeve. Ky vendim i është njoftuar subjektit përmes postës elektronike, po në datën 13.7.2021.

9. Në datën 20.7.2021, përmes postës elektronike, përfaqësuesja ligjore e subjektit dërgoi parashtrimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ, si dhe kërkoi riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera.

10. Në datën 21.7.2021, përpara seancës dëgjimore të parashikuar për t'u zhvilluar në këtë datë në orën 13:00, përfaqësuesja ligjore e subjektit paraqiti në rrugë elektronike dy dokumente shkresore të tjera, në vijim të parashtrimeve mbi rezultatet e hetimit duke kërkuar riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, si dhe shtyrjen e seancës dëgjimore për arsyet si vijojnë: (i) subjekti i rivlerësimit, për arsye shëndetësore, e kishte të pamundur të ishte i pranishëm në seancën dëgjimore duke paraqitur raportin mjekësor; (ii) përfaqësuesja ligjore e kishte të pamundur pjesëmarrjen në seancën dëgjimore të orës 13:00 për shkak të një seance gjyqësore në Gjykatën e Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit në orën 12:00, duke paraqitur fletëthirrjen e kësaj gjykate; (iii) lejet vjetore të planifikuara prej datës 1.8.2021.

11. Me vendimin nr. 4, datë 21.7.2021, Komisioni, pasi shqyrtoi parashtrimet dhe dokumentet e vëna në dispozicion nga subjekti, vendosi të shtyjë seancën dëgjimore për në datën 7.9.2021, ora 10:00, si dhe në kushte të mungesës së provave që kundërshtojnë barrën e provës, të rrëzojë kërkesën për riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera. Në datën 21.07.2021 subjektit dhe përfaqësueses ligjore iu njoftua vendimi për shtyrjen e seancës dëgjimore.

12. Në datën 22.7.2021, Komisioni informoi subjektin se kërkesa për riçelje hetimi nuk është pranuar duke iu bërë me dije se vetëm pas marrjes në shqyrtim të të gjitha parashtrimeve dhe provave, së bashku me ato që do të paraqiteshin në vijim edhe në seancën dëgjimore, trupi gjykues do të vlerësojë dhe do të vendosë në lidhje me provueshmërinë e tyre në kundërshtim të barrës së provës, si dhe riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera.

13. Në datën 7.9.2021 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm në prani edhe të avokates A. S. dhe, në përfundim, kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

14. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

15. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

16. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

17. Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

18. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit Arben Dyla ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 27.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit Arben Dyla është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me nr. indeksi *** dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private vjetore (në vijim DPV).

19. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Arben Dyla ka konstatuar se: (i) deklarimi

nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) ka mosdeklarime ndër vite të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

20. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasuritë e subjektit të rivlerësimit Arben Dyla, si dhe të personave të lidhur me të sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaramet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

21. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarameve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarameve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

22. Në deklaramtën *Vetting* subjekti ka deklaruar: *“Likuiditet në vlerën 50,000 euro e dhënë hua shtetasit A. K. me kontratën e huas me garanci me nr. ***, datë 21.12.2016. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga ndër vite e deklaruesit dhe bashkëshortes”*.

23. Në lidhje me këtë hua ILDKPKI-ja ka konstatuar:

23.1. Kontratë e dyshimtë lidhur me huan e dhënë shtetasit A. K. në shumën 50,000 euro, në vitin 2016, për të cilën nuk është deklaruar qëllimi i përdorimit të saj nga huamarrësi, si dhe mungon dokumentacioni i transaksionit të kësaj shume.

23.2. Kontratë e dyshimtë lidhur me garancitë e vëna nga huadhënësi në favor të huamarrësit, konkretisht: apartamenti me sip. 150 m² në Tiranë, të cilin subjekti e ka deklaruar në vitin 2016 se e ka në përdorim, si dhe vënien në dispozicion të huamarrësit edhe të pasurive të tjera të huadhënësit në rast të mosshlyerjes së huas dhe interesave të saj. Përveç përdorimit të pasurisë nga ana e huamarrësit, kontrata e huas parashikon edhe pagesën e interesit mujor në masën 2% mbi kapitalin e parapaguar.

23.3. Lidhur me huadhënien në shumën 50,000 euro në vitin 2016, referuar deklarameve ndër vite, subjekti nuk ka deklaruar se ka akumuluar një shumë të tillë apo konvertimin e saj dhe, më pas, e ka pakësuar këtë paradhënie.

23.4. Referuar deklaramtës së interesave private 2016 rezulton se subjekti ka mangësi në deklarim, pasi ka deklaruar huadhënien sipas kontratës përkatëse, por jo shumën dhe burimin financiar të saj.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë likuiditet të dhënë hua

24. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së¹ rezultoi se me kontratë huaje me garanci nr. ***, lidhur më 21.12.2016, me afat 5-vjeçar, midis huamarrësit A. K. dhe huadhënësit, subjektit Arben Dyla, huadhënësi jep huamarrësit huan në shumën 50,000 euro, me interes mujor 2% mbi kapitalin, i cili do të paguante pas afatit 5-vjeçar në mënyrë të menjëhershme, interesat dhe principalin. Interesi i huas është 1,000 euro/muaj ose 12,000 euro në vit dhe duke konsideruar afatin 5-vjeçar të shlyerjes dhe interesat që rrjedhin nga kjo kontratë janë në total 60,000 euro. Kështu, huamarrësi do duhet t'i kthejë subjektit huadhënësit principalin dhe interesat, në total shumën prej 110,000 euro, në datën 21.12.2021.

25. Nga verifikimi në QKB, shtetasi² A. K. rezulton të jetë ortak, administrator ose aksioner sipas përkatësisë në disa shoqëri dhe, po kështu, konfirmohet se ka pasur aktivitet tregtar³. Me qëllim zbardhjen e rrethanave në të cilat shtetasi A. K. i ka marrë subjektit të rivlerësimit hua me interes shumë më të lartë se interesi bankar dhe, për më tepër, shlyerja e huas është përcaktuar të bëhet njëherazi në përfundim të afatit 5-vjeçar, subjekti i rivlerësimit u pyet në lidhje me marrëdhënien me shtetasin A. K., për qëllimin e marrjes së huas nga ky shtetas me një interes prej 2% në muaj, ose 24% në vit, ndërkohë që interesat e kredive bankare janë disa herë më të ulta, si dhe për destinacionin e përdorimit të saj.

26. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se shtetasin A. K. e ka njohur fillimisht si bashkëqytetar nga Kavaja dhe, më pas, si biznesmen të suksesshëm. Ndërsa, sa i takon shkakut të marrjes së huas në kushtet e sipërpërmendura, subjekti ka sqaruar se kjo hua me këtë interes i ishte dhënë z. A. K. me kërkesën e tij, për shkak se llogaritë e tij bankare ishin të bllokuara dhe, për këtë arsye, nuk mund të merrte kredi dhe se nëpërmjet përcaktimit të kësaj vlere interesi, subjekti ishte joshur për t'i besuar këtij shtetasi gjithë kursimet e jetës, duke u parashikuar edhe në kontratë që detyrimi prej 50,000 euro dhe vlera e interesit të likuidoheshin njëkohësisht në fund të afatit 5-vjeçar të kontratës. Kjo edhe për faktin se brenda këtij afati, shtetasi A. K. arsyetonte se do të kishte përfunduar me sukses proceset gjyqësore me shoqërinë italiane "S. C." sh.p.k., nga të cilat do të përfitonte në total vlerën 20,000,000 euro. Kështu, sipas subjektit, vlera e huas prej 50,000 euro dhe interesi prej 60,000 euro, në total 110,000 euro që do të paguante shtetasi A. K. në fund të afatit 5-vjeçar, ishte një vlerë shumë e vogël në raport me vlerën prej 20,000,000 euro, që do të merrte nga proceset gjyqësore.

27. Sa i takon destinacionit të përdorimit të kësaj huaje, subjekti deklaroi se kjo hua do të përdorej me qëllim për të siguruar vazhdimin e aktivitetit tregtar të dy shoqërive të tij "C." sh.p.k. dhe "E. M." sh.a., përballimin e shpenzimeve gjyqësore në gjyqin e tij me shoqërinë "S. C." s.p.a., si dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj disa subjekteve tregtare me qëllim për të hequr sekuestrot bankare të llogarive të tij.

¹Shihni aktet në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

²Shkresa kthim përgjigje nr. *** prot., datë 7.8.2017 nga QKB-ja në dosjen e ILDKPKI-së: ortak 35% i shoqërisë "P." sh.p.k.; ortak 49% i shoqërisë "B. A." sh.p.k.; ortak 100% i shoqërisë "G." sh.p.k.; administrator i shoqërisë "S. S." sh.p.k.; administrator i shoqërisë "Ä." sh.p.k.; administrator dhe anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në shoqërinë "Ä. M.C." sh.p.k.; administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë "E. T." sh.p.k.; aksioner me 50% dhe anëtar i këshillit mbikëqyrës i shoqërisë "E. M." sh.a.; administrator dhe aksioner me 40% të aksioneve në shoqërinë "E.-G." sh.a.; administrator dhe ortak me 98% në shoqërinë "C." sh.p.k.; ortak 40% në shoqërinë "B. B." sh.p.k.; administrator në shoqërinë "A." sh.p.k.

³Shkresa kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.9.2017, nga DRT-ja Tiranë në dosjen e ILDKPKI-së.

Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore⁴, nga verifikimi i të cilave nuk vërtetohet destinacioni i përdorimit të shumës së marrë hua prej 50,000 euro nga huamarrësi A. K., sipas deklarimeve të subjektit.

28. Në analizë të dokumenteve që subjekti ka paraqitur, është vërtetuar se: (i) shtetasi A. K. është caktuar përfaqësues i përgjithshëm, përkatësisht, i shoqërive “C.” sh.p.k. dhe “E. M.” sh.a., që në datën 27.1.2015, në të cilat është në cilësinë e administratorit dhe ortakut të shoqërive; (ii) shoqëritë “C.” sh.p.k. dhe “E. M.” sh.a. kanë nisur procese gjyqësore ndaj shoqërive “S. C.” s.p.a dhe “S. C.” T., duke paraqitur në gjykatë kërkesëpaditë në datën 25.5.2016, pra përpara datës (21.12.2016) së lidhjes së kontratës së huas; (iii) vendimet e gjykatës nr. ***, datë 28.3.2018 dhe nr. ***, datë 10.7.2018 me palë paditëse shoqëria “E. M.” sh. a. dhe “C.” sh.p.k., kundër shoqërisë “S.” për pagimin e detyrimeve kontraktore dhe dëmit në formën e fitimit të munguar kanë marrë formë të prerë, por nuk ka të dhëna nëse këto vendime janë ekzekutuar.

29. Me qëllim vërtetimin e pretendimeve të subjektit se llogaritë bankare të shtetasit A. K. kanë qenë të bllokuara, subjektit iu kërkua të vërë në dispozicion të Komisionit urdhrat e bllokimit të llogarive bankare të shtetasit A. K. nga bankat apo shërbimi përmbarimor, si dhe çdo dokument që provon zhbllokimin e tyre. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi se nuk ka mundur të sigurojë informacion dhe paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 3.6.2021, të lëshuar nga huamarrësi A. K., ku deklaroi se: *“... në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 ‘Për mbrojtjen e të dhënave personale’, nuk jap pëlqimin që të bëhen publike të dhënat mbi detyrimet e tij, pasi i vlerësoj si të dhëna sensitive për mua”*. Ndërsa me e-mail-in e datës 8.6.2021, subjekti paraqiti vërtetim nga Banka e Shqipërisë, sipas të cilit nuk mund t’i jepej informacion për llogaritë e bllokuara të shtetasit A. K..

30. Për të vërtetuar situatën e llogarive bankare të shtetasit A. K., në cilësinë e individit/ personit fizik/personit juridik si ortak i vetëm, Komisioni iu drejtua me disa kërkesa bankave të nivelit të dytë, në përgjigje të të cilave: (i) “Tirana Bank” ka informuar se shtetasi A. K. ka pasur sekuestro konservative deri në momentin e marrjes së huas nga subjekti, si ne tabelën vijuese⁵ dhe se asnjë nga këto urdhra zhbllokimi nuk është zhbllokuar deri në momentin e kthimit të përgjigjes.

⁴Prokurë e përgjithshme nr.***, datë 27.1.2015, sipas së cilës z. A. K. emërohet drejtor ekzekutiv i shoqërisë “C.” sh.p.k.; prokurë e përgjithshme me nr. ***, datë 27.1.2015, sipas së cilës z. A. K. emërohet përfaqësues i përgjithshëm i shoqërisë “E. M.” sh.p.k.; vendim nr. ***, datë 28.3.2018 (data e regjistrimit 25.5.2016), i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas të cilit është vendosur detyrimi i palëve të paditura shoqëria “S. C. s.p.a dhe “S. C. T.” sh.p.k. të përmbushin detyrimin ndaj paditësit “C.” sh.p.k., në shumën 11,575,552.07 euro; shpërblimin e paditësit “C.” sh.p.k. për dëmin e shkaktuar nga mospërmbushja në kohë e detyrimit në shumën 141,604.92 euro; shpërblimin e dëmit paditësit “C.” sh.p.k. në formën e fitimit të munguar në shumën 4,489,055.41 euro. Vendimi ka marrë formë të prerë; vendim nr. ***, datë 10.7.2018 (data e regjistrimit 25.5.2016), i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas të cilit është vendosur detyrimi i palëve të paditura shoqëria “S. C. s.p.a dhe “S. C. T.” sh.p.k. të përmbushin detyrimin ndaj paditësit “E. M.” sh.a., lidhur me punimet e kryera nga pala paditëse dhe shërbimeve të tjera të ofruara prej saj në shumën 3,176,890.47 euro; pagimin në favor të palës paditëse shoqëria “E. M.” sh. a. të fitimit të munguar nga moskryerja në kohë e pagesave që përbëjnë detyrimet kontraktuale deri në momentin e pagimit të tyre në formën e kamatvonesave në shumën 7,356.00 euro; pagimin e fitimit të munguar si pasojë e zgjidhjes së kontratës së nënsipërmarrjes në mënyrë të njëanshme në shumën 2,095,850.00 euro. Vendimi ka marrë formë të prerë; vendim nr. ***, datë 10.7.2018, datë 10.7.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, sipas të cilit është vendosur lëshimi i urdhërekzekutimit të titullit ekzekutiv të vendimit gjyqësor civil nr. ***, datë 10.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; printime me informacion mbi projektet e shoqërisë “C.” sh.p.k., si nënkontraktore e shoqërisë “S. C. S.p.a”, etj. CV e shoqërisë “E. M.” sh.a. me informacion mbi projektet e kësaj shoqërie, ndër të cilët edhe projekti i *By-Pass-it* Vlorë si nënkontraktore e shoqërisë “S. C.” s.p.a.

⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 15.6.2021, nga “Tirana Bank”, e cila informon përveç sekuestrimeve të treguara në tabelë edhe sekuestrime të tjera, të kryera gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019.

Nr.	Data	Shuma mbi të cilën është vendosur sekuestro	Kreditore	Arsyeja	Zyra përmbartimore
1	25.6.2014	264 493 462	Raiffeisen Bank	Kthim kredie	Z.
2	26.6.2014	27 363 599	Raiffeisen Bank	Kthim kredie	Z.
3	3.7.2014	99 397 662	Raiffeisen Bank	Kthim kredie	Z.
4	4.7.2014	451 504 848	Raiffeisen Bank	Kthim kredie	Z.
Total		842 759 571			

(ii) shtetasi A. K. ka marrë disa kredi në “Raiffeisen Bank”, të cilat nuk janë paguar sipas skedulit të shlyerjes dhe, për këtë arsye, kreditore/Raiffeisen Bank ka lëshuar urdhra sekuestrimi të llogarive në bankat e nivelit të dytë, në shumën rreth 6,000,000 euro; (iii) “Raiffesien Bank”⁶ dhe “Union Bank”⁷ kanë informuar se shtetasi A. K., në cilësinë e individit, administratorit apo personit të autorizuar të disa shoqërive tregtare, ka pasur urdhra sekuestrimesh gjatë viteve 2017 – 2020 dhe një pjesë e mirë e këtyre llogarive vazhdojnë të jenë të bllokuara. Bazuar në politikat e menaxhimit të riskut të bankave të nivelit të dytë, kur një klient ka status ose sjellje të një debitori të keq, asnjë bankë nuk i lëvtron asnjë lloj kredie.

Bazuar në këto informacione, pretendimet e subjektit në lidhje me pamundësinë e shtetasit A. K. për marrjen e kredive në sistemin bankar u gjenden të bazuara në prova dhe në fakte.

31. Në vijim i është kërkuar përsëri subjektit që të vërtetojë përdorimin e shumës 50,000 euro nga shtetasi A. K., sipas destinacioneve të deklaruar prej tij, me qëllim vërtetimin e nevojës urgjente të këtij shtetasi për këtë shumë të marrë hua. Në përgjigje të kësaj kërkesë të pyetësorit nr. 3, subjekti nuk ka paraqitur dokumente shkresore për shkak të refuzimit të shtetasit A. K. për të dhënë informacion, sikurse është shprehur edhe në deklaratën noteriale nr. ***, datë 3.6.2021: “Shumën e huazuar nga z. Arben Dyla nuk e kam përdorur për asnjë qëllim të kundërligjshëm, por e kam përdorur vetëm për interesat e mia private e personale. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, ‘Për mbrojtjen e të dhënave personale’, nuk jap pëlqimin që të dhënat se ku e kam përdorur shumën 50,000 euro t’i bëj publike, pasi i vlerësoj si të dhëna sensitive për mua”.

32. Në lidhje me mënyrën e dhënies së huas, kontrata parashikon se shuma prej 50,000 euro i është lëvruar huamarrësit datë 1.12.2016, pra para nënshkrimit të kësaj kontrate datë 21.12.2016, jashtë zyrës noteriale. Nga verifikimi i të dhënave bankare konstatohet se kjo shumë nuk ka kaluar në rrugë bankare. Në lidhje me këtë, subjekti i rivlerësimit sqaroi se shuma prej 50,000 euro i është dhënë *cash* shtetasit A. K., për shkak se llogaritë e tij bankare ishin të bllokuara.

33. Në lidhje me garancinë e vendosur për shlyerjen e huas, në nenin 6.1, kontrata parashikon se huamarrësi ka vendosur si garanci një pasuri të paluajtshme *apartment me sip. 150 m², kati i pestë i ndërtuar sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 12.4.2006 të Bashkisë Tirane, e cila aktualisht është në*

⁶Shihni shkresën nr.*** prot., datë 25.6.2021, nga “Raiffeisen Bank”, administruar nga Komisioni.

⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 28.6.2021, nga “Union Bank”, administruar nga Komisioni.

*proces legalizimi sipas deklaratës nr. *** prot., datë 4.11.2014, të bërë nga shtetasi A. K.*
Bashkëngjitur kontratës janë planimetria e apartamentit dhe foto të godinës.

34. Sa i takon pasurisë apartament banimi me sip. 150 m², nga aktet ne dosje⁸, u konstatua se: (i) subjektit ndërtues “H.” sh.p.k. i është dhënë leja e ndërtimit nr. ***, dt.12.4.2006, me objekt “godinë banimi dhe shërbimi 5 kate me nënçati dhe bodrum” në Komunën F.; (ii) sipas deklaratës “Për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje”, datë nr. *** prot., datë 4.11.2014, shtetasi A. K. ka kërkuar përfshirje në procedurat e legalizimit, pa përcaktuar konkretisht objektin që legalizohet, por vetëm duke deklaruar se ndërtimi është ngritur në vitin 2010, pranë liqenit artificial. Bashkëngjitur ndodhen planimetria e apartamentit si dhe foto e ndërtesës.

35. Për të përcaktuar vendndodhjen e apartamentit dhe vlerën e tij, u ndërmorën hapat hetimore si vijojnë:

35.1 Subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ndër të tjera paraqiti kontratën nr. ***, datë 7.8.2013, “Për kalimin e të drejtës së pronësisë për një send që do të krijohet në të ardhmen”, sipas së cilës shitësi premtues D. R., i shtet blerësit A. K.: (i) gjysmën e katit të pestë që përbën sipërfaqe banimi plus aksesore prej 150 m², pasuri e cila e ka origjinën sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. ***, datë 8.5.2009; (ii) katin shtesë mbi të, që përbën katin e gjashtë të banimit, me sip. prej 331.5 m²; (iii) shtesë kati i shtatë me sip. prej 285 m²; (iv) sipërfaqe garazhe prej 77.5 m² që ndodhen në këtë pallat në katin minus. Çmimi i shitjes do të jetë në vlerën 500,000 euro, nga ku vlera prej 100,000 euro do t’i shlyhet blerësit brenda muajit gusht të vitit 2013, ndërsa pjesa e mbetur prej 400,000 euro do të shlyhet deri në datën 31.1.2014. Nga përmbajtja e kësaj kontrate konstatohet se nëpërmjet kontratës nr. ***, datë 13.6.2012, shtetasit D. R., duke qenë se kishte blerë tërësisht katin e fundit të godinës nga pronarët e godinës A. dhe A. S., i lihej e drejta e shfrytëzimit të tarracës dhe e drejta për shtesë kati në objektin me 5-6 kate me dy kate nëntokë, në komunën F..

35.2. Noteres M. C. i është kërkuar i gjithë dokumentacioni bashkëlidhur kontratës nr. ***, datë 7.8.2013, e cila me shkresën kthim përgjigje datë 1.6.2021 ka vënë në dispozicion tri kontrata noteriale, që japin informacion për sa është deklaruar nga subjekti më sipër⁹.

35.3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka sqaruar se apartamenti i marrë prej tij është në proces legalizimi dhe, konkretisht, ndodhet në ndërtesën 30, hyrja 4, kati 5, me sipërfaqe banimi plus aksesore prej 150 m². Po kështu, subjekti sqaron se nuk mund të përcaktojë çmimin e këtij apartamenti, pasi në kontratën e datës 7.8.2013 nuk është përcaktuar çmimi për metër katror, por çmimi i shitjes në total i të gjitha pasurive në total prej 500,000 euro. Me kërkesë të Komisionit, subjekti ka paraqitur: librezën e furnizimit me ujë me kontratën nr. *** dhe librezën e furnizimit me energji elektrike me kontratën nr. ***, të cilat rezultojnë të dyja në emër të shtetasit A. K..

⁸Shihni dokumentet në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, në dosjen e Komisionit.

⁹Kontratë nr. ***, datë 7.8.2013, “Për kalimin e së drejtës së pronësisë për një send që do të krijohet në të ardhmen”, midis shtetasve D. R. si palë shitëse dhe A. K. si palë blerëse; kontratë nr. ***, datë 13.6.2012 me palë A. dhe A. S. dhe D. R., ku tregohet se shtetasi D. R. ka blerë nga pala investitore një apartament banimi me sip. totale 331.5 m²; kontratë porosie nr. ***, datë 8.5.2009 sipas së cilës shtetasi D. R. ka porositur apartament me sip. 331.5 m² dhe bodrum me sip. 75.5 m². Bashkëlidhur leje ndërtimi në emër të subjektit ndërtues “H.” sh.p.k., datë 12.4.2006.

36. Nga të gjitha sa më sipër, si dhe duke ballafaquar të dhënat e kontratës nr. ***, datë 7.8.2013 me fotot e godinës, duket se shtetasi A. K. ka përfituar apartamentin me sip. 150 m², ndodhur në katin e pestë të godinës, i cili është edhe objekt i garancisë për marrjen e huas. Sa i takon vlerës specifike të këtij apartamenti, nuk ka një të dhënë konkrete dhe në këto rrethana, në përfundim të hetimit administrativ Komisioni i është referuar çmimeve të referencës dhe pikërisht udhëzimit nr. 4, datë 30.9.2015¹⁰, sipas të cilave çmimi i shitjes së apartamenteve për metër katror për zonën 5/3 të qytetit të Tiranës, ku ndodhet apartamenti objekt shqyrtimi, rezulton të jetë 107,000 lekë, që do të thotë se vlera e apartamentit është 107,000 lekë/m x 150 m² = 16.050.000 lekë ose ekuivalenti 116.600 euro¹¹.

37. Në lidhje me shtetasin A. K. janë kryer verifikime në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi dhe sipas informacionit të dërguar nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Elbasan¹², Mat¹³ dhe Lushnjë¹⁴ nuk rezulton që ky shtetas të ketë qenë kallëzues, person nën hetim, i pandehur apo i dyshuar/kallëzuar në kallëzime/procedime penale të shqyrtuara nga prokurori Arben Dyla apo cilido prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë gjatë kohës që subjekti ka qenë drejtues i kësaj prokurorie¹⁵ dhe as procedime penale¹⁶ të regjistruara në emër të tij. Nga informacioni i marrë nga Prokuroria e Përgjithshme¹⁷ rezulton se për shtetasin A. K. ka pasur dy procedime penale: procedimi penal nr. ***, i vitit 2015 për veprën penale të parashikuar në nenin 134 (vjedhje) të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (nuk ka informacion mbi ecurinë e këtij procedimi dhe prokurorinë që e ka shqyrtuar), si dhe procedimi penal i vitit 2018 për veprën penale të vetëgjyqësisë të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, trajtuar nga prokurori P. H., për të cilin është vendosur pushimi i çështjes më 24.9.2018. Subjekti nuk ka ushtruar asnjëherë detyrën në këto prokurori.

38. Sa i takon marrjes në dorëzim të pasurisë apartament banimi me sip. 150 m², rezultoi se:

38.1. Në nenin 6.2 të kontratës parashikohet se: *“Huamarrësi dhe huadhënësi bien dakord që në raste të mosshlyerjes së huas së marrë nga huadhënësi, huamarrësi përveç pasurisë së lënë si garanci mund t’i paraqesë huadhënësit edhe pasuri të tjera të paluajtshme që ai disponon, me qëllim shlyerjen e huas dhe interesave”*. Sa i takon shlyerjes së huas, në nenin 5.1 parashikohet se: *“Shlyerja totale e huas do të bëhet në fund të afatit 5-vjeçar”*. Në nenin 5.2 parashikohet se: *“Shlyerja e interesave të huas do të bëhet nga ana e huamarrësit në fund të afatit 5-vjeçar, në mënyrë të menjëhershme, interesat dhe principlali”*. Siç vërehet, huamarrësi ka marrë përsipër që t’i kthejë huadhënësit huan plus interesat, në shumën 110,000 euro, në mënyrë të menjëhershme pas 5 viteve nga nënshkrimi i kontratës datë 21.12.2021. Në rast të mospërmbushjes së këtij detyrimi, do t’i dorëzonte apartamentin me sip. 150

¹⁰https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/11/UKM-4-dt.-30.09.15-Kosto-mes.ndert_.banesave-2015.pdf

¹¹1 euro = 137.65 lekë sipas Bankës së Shqipërisë datë 31.12.2015.

¹²Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në dosjen e Komisionit.

¹³Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 7.5.2021, në dosjen e Komisionit.

¹⁴Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2021 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në dosjen e Komisionit.

¹⁵Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 15.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

¹⁶Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2021, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

¹⁷Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.6.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme në dosjen e Komisionit.

m². Pra, është e qartë se apartamenti i vënë si garanci (dhe jo vetëm) do të dorëzohej vetëm në rast të mosshlyerjes së huas, së bashku me interesat me mbarimin e afatit 5-vjeçar.

38.2. Në DPV-në për vitin 2016 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si adresë vendbanimi adresën e kësaj pasurie, pra, ka banuar në këtë pasuri menjëherë me lidhjen e kontratës së huas, fakt që është konfirmuar edhe me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ku subjekti ka deklaruar se në këtë apartament familja e tij ka nisur të banojë në janar të vitit 2017 dhe se nuk ka kryer asnjë shpenzim mobilimi, pasi apartamenti ka qenë i pajisur me mobilje, për shkak se më parë ka banuar familja e shtetasit A. K..

38.3. Në vijim, subjektit iu kërkua të japë shpjegime se përse ka filluar të përdorë apartamentin menjëherë pas nënshkrimit të kontratës në kushtet kur një fakt i tillë nuk ishte parashikuar në kontratë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti ka deklaruar: *“Përpara nënshkrimit të kontratës së huas mes meje dhe z. A. K. kemi diskutuar me njërin-tjetrin, duke e parë dhe vlerësuar këtë kontratë secili sipas interesit të tij. Interesi i z. A. K. nga kontrata e huas ishte: (i) të merrte hua nga unë cash shumë 50,000 euro; (ii) të fitonte 5 vjet kohë për shlyerjen e saj, pasi gjatë gjithë periudhës 5-vjeçare, z. A. K. nuk do të kishte asnjë detyrim për të paguar pasi i gjithë detyrimi i tij, hua dhe interesa, do të paguhej në fund të afatit 5-vjeçar. Ndërsa interesi im prioritar, si në kohën e nënshkrimit të kontratës së huas me z. A. K. por edhe aktualisht, është të siguroj një banesë për familjen time. Për sa më sipër kam rënë dakord verbalisht me z. A. K. që: Duke qenë se z. A. K. nga momenti i nënshkrimit të kontratës së huas deri në fund të saj nuk do të paguante asnjë interes mujor mbi huan që unë i kisha dhënë, z. A. K. nga momenti i nënshkrimit të kontratës e deri në përfundim të saj do të vinte në dispozicionin tim për të banuar familja ime, apartamentin e lënë si garanci për shlyerjen e kontratës së huas me sip. 150 m² dhe plotësisht të mobiluar duke qenë se më parë në këtë banesë ka banuar familja e z. A. K.. Kontrata e huas mes meje dhe z. A. K. nuk parashikon që në rast të mosshlyerjes së huas, apartamenti i lënë si garanci për shlyerjen e huas, menjëherë në datën 21.12.2021, të merret në dorëzim nga ana ime. Në rast të mosshlyerjes së huas nga z. A. K., në fund të afatit 5-vjeçar të përfundimit të kontratës së huas datë 21.12.2021, siç është parashikuar në kontratën e huas pika 6.2, ‘Huamarrësi përveç pasurisë së lënë si garanci mund të paraqes huadhënësit edhe pasuri të tjera të paluajtshme që ai disponon me qëllim shlyerjen e huas dhe interesave’”.*

Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 3.6.2021, të shtetasit A. K., në të cilën konfirmon deklaratimet e subjektit.

38.4. Siç vërehet, sipas arsytimit të subjektit, duket se në marrëdhënien dypalëshe secila palë ka vepruar sipas interesit të saj sipas një marrëveshjeje të dakordësuar përpara nënshkrimit të kontratës së huas dhe se ata kanë rënë dakord që apartamenti t’i dorëzohej subjektit me nënshkrimin e kontratës. Sa i takon interesit të shtetasit A. K., me sa duket subjekti i referohet faktit se ai ka pasur një nevojë urgjente përpara, pasi ka pasur çdo llogari të bllokuar. Sa i takon interesit të tij, subjekti ka deklaruar shprehimisht *“... ndërsa interesi im prioritar, si në kohën e nënshkrimit të kontratës së huas me z. A. K., por edhe aktualisht është të siguroj një banesë për familjen time”*, fakt që hedh dritë mbi dyshimin se subjekti ka pasur si qëllim blerjen e pasurisë të vënë si garanci hipotekore.

38.5. Pavarësisht çdo argumenti të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, deklaratimet e tij se midis palëve ka pasur një marrëveshje paraprake verbale për dorëzimin e pasurisë që në momentin e nënshkrimit të

kontratës së huas, përveç se vijnë në kundërshtim me parashikimin e kësaj kontrate, e cila parashikon që pasuria do të dorëzohet në rast të mosshlyerjes së huas (me mbarimin e afatit 5-vjeçar), mbeten në nivel deklarativ. Edhe nëse do të merrej e mirëqenë një marrëveshje paraprake mes palëve për dorëzimin e pasurisë me lidhjen e kontratës së huas, mbetet e paqartë përse ky vullnet i palëve nuk është shprehur në kontratë në mënyrë të shkruar.

39. Nga të gjitha provat e administruara si më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kërkuar të japë sqarime dhe të paraqesë prova për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve si vijojnë. Duket se:

39.1 Subjekti i rivlerësimit Arben Dyla i ka dhënë shtetasit A. K., jashtë sistemit bankar, huan në shumën 50,000 euro, me interes 2%/muaj mbi kapitalin, pra me një interes sa shumëfishi i interesit bankar dhe 10,000 euro më të lartë se vetë huaja.

39.2 Me lidhjen e kontratës së huas me garanci, në dhjetor të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka nisur të banojë në apartamentin e lënë si garanci, çka bën që ky apartament ta humbasë kuptimin e garancisë të rregulluar nga dispozitat përkatëse të Kodit Civil, si një mjet për të siguruar përmbushjen e një detyrimi kontraktor, në rastin konkret për të siguruar shlyerjen e huas. Për më tepër, sipas kontratës (neni 6 i saj), vetëm në rast të mosshlyerjes së huas, subjektit të rivlerësimit do t'i kalonte pasuria e vendosur si garanci. Për rrjedhojë, duket se subjekti e ka blerë *de facto* apartamentin e lënë si garanci për huan.

39.3 Vlera e pasurisë sipas çmimeve referencë është 16,050,000 lekë/116.600 euro, pothuajse e barabartë me atë të huas së bashku me interesat në vlerën 110,000 euro.

39.4 Pavarësisht një nevoje urgjente për vlera monetare në kushtet e pamundësisë objektive për të marrë kredi, shtetasi A. K. ka pranuar të shesë apartamentin me një humbje në vlerën 60,000 euro, ndërkohë që mund të shiste në rastin më të keq në një çmim sado pak më të lartë se shuma e huas prej 50,000 euro. Nga ana tjetër i ka dhënë pasurinë të mobiluar subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që mund ta jepte me qira, duke pësuar edhe një humbje tjetër për shkak të fitimit të munguar të qirave për 5 vjet.

39.5. Për të gjitha këto arsye, duket se subjekti i ka paguar shtetasit A. K. shumën prej 110,000 euro dhe, për këtë shkak, në analizën financiare në përfundim të hetimit administrativ, e cila mund të ndryshojë në procesin e vlerësimit përfundimtar në varësi të provave që subjekti mund të paraqesë në ushtrim të barrës së provës, kjo vlerë është konsideruar si shpenzim gjatë vitit 2016.

40. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

40.1. Në lidhje me dhënien e huas me një interes sa shumëfishi i interesit bankar dhe 10,000 euro me të lartë se vetë huaja, në parashtrimet e tij subjekti e ka konsideruar këtë konstatim jo të drejtë, duke sjellë në vëmendje të Komisionit vlerën e interesit të aplikuar nga institucioni financiar “Fondi Besa”, i cili si vlerë minimale të interesit ka 24% në vit dhe maksimale 28% në vit. Pavarësisht se ky konstatim i subjektit mund të jetë i vërtetë, Komisioni vlerëson se nuk mund të vihet shenjë barazimi midis një individi huadhënës dhe një subjekti të licencuar për dhënien e kredive, pasi objekti kryesor i aktivitetit tregtar që ushtrojnë këto institucione është dhënia e kredive. Gjithashtu, këto institucione kanë struktura organizative të zgjeruara, kosto operationale të konsiderueshme dhe marrin përsipër risqe të larta të

mosshlyerjes së kredive, faktorë që justifikojnë interesa të larta të kredidhënies, madje edhe më të larta në krahasim me banka të nivelit të dytë. Një individ që nuk plotëson asnjë nga kushtet e një institucioni financiar, nuk mund të krahasohet me to, jo vetëm sa i takon interesit të aplikuar, por as nuk mund të pretendojë se dhënia me hua prej tij është një veprim i krahasueshëm me atë të një institucioni financiar.

40.2. Në lidhje me marrjen në dorëzim të pasurisë, në parashtrimet e tij subjekti ka pretenduar se ka nisur të banojë në apartamentin e shtetasit A. K. në janar të vitit 2017 dhe jo menjëherë me nënshkrimin e kontratës së huas në dhjetor të vitit 2016, duke deklaruar se e vërteton këtë fakt me librezën e pagesës së televizionit kabllor “C. A.” Kavajë, dokument të cilin e paraqiti në seancë dëgjimore. Në fakt, konstatimi i Komisionit se subjekti ka nisur përdorimin e kësaj banese menjëherë me nënshkrimin e kontratës së huas, i referohet faktit se përdorimi i saj në janar të vitit 2017 nga subjekti, ka nisur brenda një kohe shumë të shkurtër nga data e lidhjes së saj 21.12.2016, fakt që vjen në kundërshtim me parashikimet kontraktore.

40.3. Sa i takon konstatimit se ky apartament ka humbur kuptimin e garancisë të rregulluar nga dispozitat përkatëse të Kodit Civil, ky konstatim jo vetëm që nuk u rrëzua në ushtrim të barrës së provës, por sipas parashtrimeve të përfaqësueses ligjore të subjektit: *“Kontrata e huas nuk është e vlefshme juridikisht në këtë pikë, pasi apartamenti i vendosur si garanci është në proces legalizimi dhe i paregjistruar dhe, për këtë arsye, nëse huaja nuk shlyhet është e pamundur që apartamenti të kalojë në pronësi të z. Arben Dyla për shkak të mosregjistrimit, pra kjo garanci nuk mund të zbatohet në mënyrë të detyrueshme”*. Ndërkohë, nga ana e përfaqësueses pretendohet se përdorimi i kësaj banese të pahipotekuar nga z. Arben Dyla ka qenë e vetmja garanci për të, duke nënkuptuar që nëse huaja nuk kthehej sipas kontratës, z. A. K. (dhe jo vetëm ai) nuk do të mund t’ia merrte pasurinë subjektit të rivlerësimit për shkak se ka qenë e pahipotekuar, fakt që hedh dritë mbi dyshimin e ngritur nga Komisioni se subjekti e ka blerë *de facto* këtë pasuri.

40.4. Po kështu, nga subjekti parashtrohet se Komisioni nuk ka provuar falsitetin e kontratës së huas dhe se Komisioni është bazuar mbi disa *indicie* të parëndësishme dhe të pasakta në kundërshtim me sa parashikohet në nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga *indiciet* nëse ato nuk janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën. Përkundër sa pretendohet, në asnjë moment nga ana e Komisionit nuk është konstatuar falsiteti i kontratës së huas, por se të dhënat që disponohen në vlerësim tërësor të të gjitha rrethanave të çështjes, ngrenë dyshime të arsyeshme se kontrata e huas, të cilën subjekti e ka vlerësuar të pavlefshme juridikisht sa i takon objektit të vënë si garanci, është një kontratë që nuk ka pasur si qëllim dhënien e huas, por përfitimin e pasurisë apartament banimi.

40.5. Më tej, në parashtrime, pretendohet se kontrata e huas nr. ***, nuk parashikon që nëse huamarrësi nuk paguan huan dhe interesat do të bëhet kalimi i menjëhershëm i pasurisë së vendosur si garanci, pasi sipas nenit 6/2 të kontratës, pasuria objekt shqyrtimi nuk ka qenë e vetmja garanci. Në fakt, përkundër sa pretendohet nga subjekti, në nenin 6.2 të kontratës, parashikohet qartësisht se pasuria objekt shqyrtimi do të dorëzohet te subjekti në rast të mosshlyerjes së huas nga huamarrësi. Sa i takon pasurive të tjera të vëna si garanci, është e vërtetë që në nenin 6/2 të kontratës është parashikuar edhe paraqitja e pasurive të tjera në pronësi të huamarrësit, por ky parashikim, më shumë se një garanci për shlyerjen e huas, mund të vlerësohet si një përpjekje e subjektit për të mbuluar pikërisht qëllimin e përfitimit të

pasurisë objekt shqyrtimi. Kjo për faktin se në kontratë nuk përcaktohet asnjë pasuri tjetër konkrete e huadhënësit dhe, për më tepër, në kushtet kur huadhënësi A. K. ka qenë debitor në disa banka, subjekti nuk mund të kishte asnjë garanci që pasuri të tjera të këtij shtetasi do të shërbenin si mjet për të garantuar marrjen e shumës prej 110,000 euro.

40.6. Në lidhje me konstatimin se vlera e pasurisë sipas çmimeve referencë është 16,050,000 lekë/116,600 euro, pothuajse e barabarte me atë të huas së bashku me interesat në vlerën 110,000 euro, në parashtrimet e veta, subjekti ka pretenduar se asnjëherë nuk është diskutuar ndërmjet palëve vlera e apartamentit të lënë si hua. Ndërkohë, përkundër sa pretendohet nga subjekti, Komisioni çmon se nisur nga vetë kushtet e kontratës, sipas së cilës subjekti do të përfitonte apartamentin nëse në fund të afatit 5-vjeçar nuk do të likuidohej vlera totale prej 110,000 euro, palët janë dakordësuar në një mënyrë që vlera e apartamentit të vënë si garanci ka qenë 110,000 euro.

40.7. Subjekti ka kundërshtuar çmimin e apartamentit të vlerësuar nga Komisioni prej 116,000 euro, duke paraqitur një akt vlerësimi të pasurisë nga një vlerësues i licencuar i pasurive të paluajtshme, nga ku rezulton se apartamenti objekt vlerësimi i përket zonës 2/5 të qytetit të Tiranës dhe se çmimi i referencës për metër katror në vitin 2016, për këtë zonë, ka qenë 80,000 lekë. Sipas përlllogaritjeve të kryera nga vlerësuesi, vlera e apartamentit sipas çmimit të referencës është 88,757 euro dhe jo 116,000 euro sikurse është vlerësuar nga Komisioni. Në vlerësim të këtij pretendimi, Komisioni e gjeti të bazuar, pasi vlera e pasurisë sipas çmimeve referencë nuk është aq sa ishte llogaritur nga Komisioni në përfundim të hetimit administrativ, por 88,757 euro/12,000,000 leke¹⁸. Por, në fakt, shuma që huamarrësi do t'i jepte huadhënësit në përfundim të afatit 5-vjeçar, sipas kontratës, nuk është as vlera e riparë nga Komisioni sipas çmimeve referencë prej 88,757 euro dhe as ajo që shtetasi A. K. është përlllogaritur të ketë paguar për blerjen e pasurisë apartament me sip. 150 m², në vlerën 91.536 euro¹⁹, sikurse dhe subjekti pretendoi në parashtrimet e tij, por më e lartë se të dyja këto vlera, në shumën 110,000 euro, fakt që hedh dritë mbi dyshimin se pasuria apartament banimi me marrëveshje të palëve është blerë *de facto* në këtë vlerë.

40.8. Sa i takon konstatimit të humbjes që ka pësuar z. A. K. për shkak të interesit të lartë të huas, subjekti ka sqaruar se interesi i lartë i huas ka qenë për shkak se ky shtetas ka marrë një hua pa procedura të gjata të menjëhershme, nga një mik i tij në mirëbesim, pa pasur presionin e bllokimit të llogarive bankare për të kryer shpenzime të domosdoshme në kushtet kur ishte në një situatë shumë të vështirë financiare. Më tej, nga subjekti parashtrohet se përkundër sa ka vlerësuar Komisioni, z. A. K. nuk mund ta shiste apartamentin në një çmim më të shtrenjtë se 50,000 euro, pasi pasuria nuk ishte e regjistruar, pretendim i cili është i bazuar, por ky fakt nuk përjashton mundësinë që shtetasi A. K., i cili ka pasur nevojë urgjente për para, mund të kishte dhënë pasurinë me qira për një afat prej 5 vjetësh. Gjithsesi, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, argumentet e paraqitura nga subjekti nuk justifikojnë

¹⁸(150 m² x 80.000 lekë/m²) sipas çmimit të referencës së zonës 2/5 referuar udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016".

¹⁹Përlllogaritja është kryer nisur nga shuma totale prej 500,000 euro, të cilat i ka paguar z. A. K. sipas kontratës datë 7.8.2013 për blerjen e sip. 766 m² sip. apartamentesh (përkatësisht 331.5m² dhe 285 m² dhe 150 m²) dhe sip. garazhe 75.5m². Çmimi i sipërfaqeve të garazheve është 70% i çmimit të apartamentit, sipas vendimit nr. ***, datë 3.6.2015, të DPT-së "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore".

bindshëm humbjen nga ana e huamarrësit për shkak të interesit të lartë, si dhe humbjen e fitimit të munguar për shkak të dhënies në përdorim të pasurisë pa shpërblim²⁰.

41. Në konkluzion të parashtrimeve, subjekti pretendon se asnjëherë nuk ka pasur si qëllim fitimin e pronësisë së apartamentit objekt shqyrtimi dhe se marrëdhënia mes tij dhe shtetasit A. K. ka qenë një marrëdhënie huaje. Po kështu, kërkon që Komisioni duhet të konkludojë në përfundimin e sigurt, tej çdo dyshimi të arsyeshëm që z. Arben Dyla i ka dhënë z. A. K. vetëm shumën 50,000 euro si hua dhe vetëm kjo shumë duhet të vendoset si shpenzim në analizën financiare.

Arsyetim ligjor mbi bazën e fakteve dhe ligjit të zbatueshëm

42. Në analizë të të gjitha parashtrimeve të subjektit, provave të administruara nga hetimi administrativ dhe bazuar në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë²¹ për të kryer një vlerësim sa më objektiv të sjelljeve të subjektit në marrëdhënien e huas e në kuadër të procesit të rivlerësimit, pa zëvendësuar rolin e një gjykate që shqyrton këtë marrëdhënie, por për të kuptuar sa më shumë qëllimin e vërtetë të subjektit, Komisioni iu referua fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

42.1. Interesi shumë i lartë i huas: 2% në muaj mbi kapitalin, pra një interes sa shumëfishi i interesit bankar dhe 10,000 euro më të lartë se vetë huaja.

Është e vërtetë se neni 1051 i Kodit Civil dhe vijues (kontrata e huas) parashikon vendosjen e detyrimit për pagimin e kamatave sipas marrëveshjes së palëve dhe se mospagimi i kamatave përbën mospërbushje thelbësore të detyrimit, por duke qenë se Kodi Civil shqiptar nuk ka parashikuar ndonjë kufi maksimal të kamatave të lejuara, siç parashikojnë legjislacione të vendeve të tjera, mund t'i referohemi dispozitave të përgjithshme të tij. Kështu, në nenin 422 të Kodit Civil parashikohet se *“Kreditori dhe debitori duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me korrektesë, me paanësi dhe sipas kërkesave të arsyes”*, çka nënkupton që liria e kontraktimit nuk është absolute, por kufizohet nga disa faktorë ekonomikë dhe moralë, ndërsa në nenin 686/2 të Kodit Civil parashikohet se *“Janë të pavlefshme kushtet e përgjithshme që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të palës kontraktuese, posaçërisht kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë të shprehura në dispozitat e këtij kodi që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale”*, çka nënkupton që kamatat që kapërcejnë limitin e lejuar nga logjika ekonomike, arsyeja apo morali, përbëjnë një kusht pavlefshmërie.

Veç të gjitha sa është arsyetuar në këtë vendim, sjellja e subjektit si një institucion financiar, duke pranuar me vullnetin e tij një interes huaje që kapërcen çdo limit të lejuar dhe tej arsyes dhe logjikës ekonomike, e ndërthurur me elemente faktike të ekzistencës së një marrëdhënieje që nuk ka pasur si qëllim dhënien e huas, por përfitimin e pasurisë apartament banimi, vlerësohet nga Komisioni në disfavor të tij, në raport me të gjitha elementët e tjera të vlerësimit të kriterit pasuror sipas dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016.

²⁰Qiraja për 5 vite, sipas çmimeve të referencës të zonës do të ishte 2,160,000 lekë ose rreth 16,000 euro (36,000 lekë/muaj) sipas VKM-së nr. 469, datë 3.6.2015, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”.

²¹Shihni vendimin nr. 932, nr.1800 i regjistrit themeltar të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

42.2. Garancia pasurore e kontratës së huas: apartament me sip. 150 m², i paregjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme, si dhe pasuri të tjera të pidentifikuara dhe të paregjistruara.

Në nenin 195 të Kodit Civil parashikohet se: *“Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato që janë fituar ose njohur sipas dispozitave të këtij Kodi, nuk mund të tjetërsohen dhe kur është rasti, të ngarkohen me barrë, në rast se nuk është bërë regjistrimi i tyre në regjistrat publikë”*. Pra, në kuptim të kësaj dispozite ligjore, huaja nuk mund të ekzekutohej në mënyrë të detyrueshme sipas kushteve të përcaktuara në të me kalimin e afatit 5-vjeçar, për sa kohë apartamenti i vënë si garanci ka qenë e paregjistruar në regjistrat publikë, ndërkohë që pavarësisht parashikimit në kontratë, mungon të jenë vënë si garanci për dhënien e huas pasuri të tjera konkrete dhe të regjistruara në emër të huamarrësit.

42.3. Marrja në përdorim nga subjekti i apartamentit të vendosur si garanci për huan, në kundërshtim me çfarë parashikon kontrata e huas, është një tregues që hedh dritë mbi dyshimet se qëllimi i vërtetë i kontratës së huas ka qenë përfitimi i apartamentit nga subjekti.

42.4. Vlera e pasurisë sipas çmimeve të referencës

Pavarësisht se prapësimi i subjektit mbi vlerën e apartamentit bazuar në çmimin e referencës qëndron dhe vlera referencë është 12,000,000 lekë ose ekuivalenti 88,757 euro, duke mbajtur parasysh se çmimet e referencës janë çmime dysheme dhe, si rregull, më të ulëta se çmimi i tregut, përsëri vlera e apartamentit ~ 89,000 euro është më e afërt me shumën 110,000 euro (huaja së bashku me interesat) sesa me shumën e huas së dhënë nga subjekti në vlerën prej 50,000 euro.

42.5. Risku i lartë financiar që ka marrë përsipër subjekti

Mbeten të paqarta arsyet se si subjekti ka dhënë tek z. A. K. të gjitha kursimet e jetës së tij që rrjedhin nga paga, duke ndërmarrë përsipër risqe shumë të larta dhe konkretisht: (i) garancia e vendosur mbi apartamentin nuk ka vlerë ligjore, pasi është i pahipotekuar; (ii) llogaritë bankare të z. A. K. kanë qenë të bllokuara me urdhra sekuestrosh konservativë për shkak të detyrimeve të pushyera në shuma shumë të mëdha të tij/të bizneseve të tij, ndaj disa bankave dhe organeve tatimore; (iii) edhe në rast të zhbllokimit të llogarive të z. A. K., për shkak të detyrimeve shumë të mëdha të tij, kreditorët mund të ekzekutojnë çdo pasuri të paluajtshme të tij duke zvogëluar realisht mundësinë që ndonjë tjetër pasuri e tij të kalojë në favor të subjektit në rast të moskthimit të shumës prej 110,000 euro; (iv) z. A. K. nuk rezulton t'i ketë dhënë/vërtetuar subjektit asnjë siguri reale për ecurinë e gjyqeve me shoqërinë italiane apo për mundësinë e sigurimit të të ardhurave të tjera për shlyerjen e huas së bashku me interesat; (v) subjekti ka bllokuar të gjitha kursimet e jetës së tij për 5 vjet, në kushtet e mungesës së një garancie reale për t'i marrë ato, duke humbur kështu mundësinë për të blerë një tjetër banesë për të cilën ai dhe familja e tij kanë pasur nevojë.

Për të gjitha sa është arsyetuar më sipër, kontrata e huas nr. ***, datë 21.12.2016, duket të jetë një veprim juridik fiktiv në kuptim të nenit 92 të Kodit Civil, pasi nuk ka pasur si qëllim dhënien e huas, por përfitimin e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit. Sa i takon shumës prej 110,000 euro, e cila në përfundim të hetimit administrativ është konsideruar si shpenzim nga subjekti, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, referuar parashtrimeve të subjektit dhe në kushtet e mungesës së provave, Komisioni nuk arriti të krijojë bindjen që subjekti i ka dhënë

huamarrësit A. K. shumën prej 110,000 euro dhe, për rrjedhojë ka përfshirë si shpenzim në analizën financiare të vitit 2016 vetëm shumën e dhënë hua prej 50,000 euro.

43. Në lidhje me huan prej 50,000 euro dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e saj, nga verifikimi i deklarimeve të subjektit konstatohet se:

43.1. Në DPV-në e vitit 2016 subjekti nuk ka deklaruar shumën e dhënë hua, pakësim likuiditetesh për shkak të dhënies së huas dhe as burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e saj, por në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” subjekti ka deklaruar kontratën e huas me garanci nr. ***, datë 21.12.2016, me shtetasin A. K..

43.2. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim krijimi të huas prej 50,000 euro të ardhurat nga paga ndër vite të deklaruësit dhe bashkëshortes.

44. Me qëllim evidentimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për dhënien e huas në datën 21.12.2016, nga Komisioni u kryen verifikimet si vijojnë:

44.1. Në DPV-të përkatëse subjekti ka deklaruar gjendje *cash* të paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese.

Vitet	Shuma e deklaruar	Me fjalë	Gjendja e likuiditeteve sipas deklarimeve të subjektit në DPV-të
DPV/2003	450 000 lekë	gjendje <i>cash</i>	450 000
DPV/2004	8 000 USD	gjendje <i>cash</i>	756 640 ²²
DPV/2005	750 000 lekë	gjendje <i>cash</i>	750 000
DPV/2006	250 000 lekë	gjendje <i>cash</i>	250 000
DPV/2007	700 000 lekë	gjendje <i>cash</i>	700 000
DPV/2008	600 000 lekë	gjendje <i>cash</i>	600 000
DPV/2009	700 000 lekë	gjendje <i>cash</i>	700 000
DPV/2010	700 000 lekë	shtuar gjendje <i>cash</i>	1 400 000
DPV/2011	700 000 lekë	pakësime: gjendja <i>cash</i> që disponohet nga personi	700 000
DPV/2012	600 000 lekë	gjendje <i>cash</i> , të ardhura nga paga e deklaruësit dhe bashkëshortes	600 000
DPV/2013	600 000 lekë	gjendje <i>cash</i> , të ardhura nga paga e deklaruësit dhe bashkëshortes	600 000
DPV/2014	700 000 lekë	gjendje <i>cash</i> , e krijuar nga të ardhurat nga paga e deklaruësit dhe bashkëshortes	700 000
DPV/2015	200 000 lekë	gjendje <i>cash</i> , e krijuar nga të ardhurat nga paga e deklaruësit dhe bashkëshortes	200 000
DPV/2016	300 000 lekë	në pronësi: likuiditet. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga e deklaruësit dhe bashkëshortes	300 000

²²Kursi i këmbimit është 1 USD = 94.58 lekë, Banka e Shqipërisë datë 31.12.2004.

44.2. Subjekti, i pyetur në ILDKPKI në lidhje me gjendjen *cash* deri në datën 31.12.2014²³ ka deklaruar një gjendje të ndryshme të likuiditeteve *cash* ndër vite, si vijon: “... në vitin 2004 kam deklaruar gjendje *cash* në vlerën 8,000 USD, e cila përfshin kursimet *cash* nga viti paraardhës dhe kursime të vitit 2004, të cilat i kam konvertuar në dollarë. Në vitin 2005 kam realizuar shtesë në vlerën 750,000 lekë në total, që përfshin edhe gjendjen shtesë në llogarinë e pagës. Gjendja *cash* e krijuar në vitin 2005 ka qenë 238,000 lekë. Në vitin 2006 kam shtuar 250,000 lekë në total, që ka përfshirë edhe shtesën në likuiditet në llogarinë e pagës dhe kështu vazhdon në vitet pasardhës. Në vitet që unë kam pakësuar gjendjen e llogarisë së pagës, përsëri shtesa e deklaruar *cash* ka përfshirë dhe pakësimin. Sqaroj se disponoj gjendje *cash* në vlerën 8,000 USD dhe 3,549,650 lekë”.

Siç vërehet, në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar një mënyrë të ndryshme nga ajo në deklaratat periodike vjetore, sa i takon gjendjeve *cash* në fund të çdo viti. Konkretisht, sipas procesverbalit të datës 16.2.2016, subjekti deklaroi se: (i) gjendja e deklaruar prej tij nga viti në vit përfaqëson shtesa likuiditetesh të vitit të kaluar dhe jo gjendje *cash*; (ii) brenda shtesës së likuiditetit të deklaruar është përfshirë edhe shtesa e gjendjes së llogarisë bankare të pagës; (iii) në ato vite kur është pakësuar gjendja e llogarisë së pagës, përsëri shtesa e deklaruar *cash* ka përfshirë edhe këtë pakësim.

44.3. Për shkak se deklaratimet në ILDKPKI janë jo vetëm të ndryshme nga ato të deklaruara në deklaratat periodike vjetore, por edhe të paqarta, subjekti u pyet përsëri për të saktësuar edhe një herë shtesat/pakësimet gjatë çdo viti, si dhe gjendjen *cash* në fund të çdo viti. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka prezantuar situatën si vijon.

Vitet	Shtesa/pakësime gjatë vitit <i>cash</i> në banesë (lekë)	Shtesa/pakësime gjatë vitit në llogarinë e pagës së subjektit (lekë)	Shtesa/pakësime gjatë vitit në llogarinë e pagës së bashkëshortes (lekë)	Gjendja në fund të çdo viti
2003	450 000			450 000 lekë 8 000 USD
2004	720 000			450 000 lekë dhe 8 000 USD
2005	237 752	512 248		687 752 lekë dhe 8 000 USD
2006	111 957	138 043		799 709 lekë dhe 8 000 USD
2007	869 575	-169 575		1 669 283 lekë dhe 8 000 USD
2008	868 574	-268 574		2 537 857 lekë dhe 8 000 USD
2009	508 669	191 331		602 526 lekë dhe 8 000 USD/ 20 000 euro
2010	799 401	-99 401		1 401 927 lekë dhe 8 000 USD/ 20 000 euro
2011	-700 000	89 388		701 927 lekë dhe 8 000 USD/ 20 000 euro
2012	516 799	83 201		1 218 726 lekë dhe 8 000 USD/ 20 000 euro
2013	667 467	-67 467		1 886 193 lekë dhe 8 000 USD/ 20 000 euro
2014	317 616	382 384	-61 621	2 265 429 lekë dhe 8 000 USD/ 20 000 euro

²³Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2020, ILDKPKI-ja ka vënë në dispozicion të Komisionit procesverbalin, i cili është mbajtur në datën 16.2.2016 dhe DPV-ja e fundit e plotësuar dhe e dorëzuar nga subjekti ka qenë ajo për vitin 2014. Për këtë arsye subjekti është pyetur për gjendjen *cash* deri në datën 31.12.2014.

2015	210 827	589 173	2 476 256 lekë dhe 8 000 USD/ 20 000 euro
------	---------	---------	--

Sqarimet e dhëna në pyetësonin nr. 2 janë në të njëjtën linjë – pra deklarim shtesash nga viti në vit dhe jo gjendje likuiditetesh *cash* – me deklarimet e bëra nga subjekti në datën 16.2.2016, në ILDKPKI, por përsëri vërehen disa ndryshime nga krahasimi i dy versioneve. Konkretisht, në sqarimet e pyetësonit nr. 2 evidentohet se: (i) në vitin 2009 subjekti ka prezantuar për herë të parë konvertimin e kursimeve të akumuluarra deri në vitin 2008 nga lekë në euro (20,000 euro) dhe shumën në euro e ka mbartur deri në fund të vitit 2015. Kursimet e konvertuara në euro nuk janë deklaruar asnjëherë as në DPV-të përkatëse, as në procesverbalin në ILDKPKI; (ii) për herë të parë dhe vetëm në vitin 2014, subjekti ka përfshirë në deklarimin e likuiditeteve të tij edhe ndryshimin e llogarisë së pagës së bashkëshortes, ndërkohë që bashkëshortja ka llogari page të çelur që në vitin 2009, vit kur është martuar me subjektin.

45. Në përfundim të hetimit administrativ, sa i takon burimit të krijimit të shumës prej 50,000 euro, subjektit iu kërkua të japë sqarime dhe dokumente në ushtrim të barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në lidhje me konstatimet, duket se:

45.1 Në deklaratën për vitin 2016 nuk ka deklaruar shumën e huas, pakësim likuiditetesh për dhënien e saj, si dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e saj, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

45.2 Për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti prezanton konvertimin e kursimeve të akumuluarra deri në vitin 2008, në shumën 20,000 euro, shumë të cilën pretendon se e ka mbartur deri në fund të vitit 2015.

45.3 Ka mospërputhje në deklarimet e gjendjeve *cash* nga subjekti. Në deklarimet e gjendjeve sipas variantit të paraqitur në ILDKPKI, duket se subjekti ka pasur në fund të vitit 2014, shumën prej 3,549,650 lekësh dhe 8,000 USD, e cila nuk është e njëjtë me gjendjen e likuiditeteve *cash* që subjekti deklaroi hollësisht në pyetësonin nr. 2.

45.4 Në të gjitha DPV-të, subjekti ka qenë shumë i qartë dhe i saktë në deklarimet e gjendjeve *cash*: (i) në vitet kur ka deklaruar gjendje *cash* dhe vlera është më e lartë se e vitit paraardhës, do të thotë që diferenca është shtesë; (ii) në vitet kur vlera është më e vogël se viti paraardhës, do të thotë që diferenca është pakësim; (iii) në DPV-të për vitet 2010 dhe 2011 ka deklaruar saktësisht shtesë dhe pakësim të gjendjeve *cash*, përkatësisht në vlerat 1,400,000 lekë dhe 700,000 lekë.

45.5 Është e paqartë se cilat janë arsyet që, sipas versionit të pretenduar gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka mbajtur në shtëpi gjendjet *cash* të krijuara që nga vitet 2003 - 2015, duke bërë konvertimin në euro vit pas viti të shtesave të likuiditeteve të pretenduara, pa i depozituar ato në bankë.

45.6. Bazuar në të gjitha sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ është kryer analiza financiare sipas deklarimeve të subjektit në DPV si në tabelën vijuese, sipas së cilës subjekti është në pamundësi financiare për dhënien e huas në shumën 50,000 euro në dhjetor të vitit 2016, për shkak të një balance negative në shumën 5,603,853 lekë.

Përshkrimi	2016
Pasuri	5 531 816
Dhënë hua 50,000 euro	6 763 500
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	<i>-1 231 684</i>
Likuiditete gjendje	431 831
Të ardhura dokumentuar	1 436 641
Të ardhura nga paga e subjektit	1 019 249
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	415 798
Nga interesat bankare	1 594
Shpenzime	1 508 677
Shpenzime jetese për 4 persona	901 186
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	108 216
Shpenzime transporti sipas pyetësorit 2	160 575
Shpenzime mobilimi sipas pyetësorit standard	20 000
Paguar shkolla e djalit	311 700
Shpenzime të tjera/të ndryshme	7 000
Mundësia për kursime	-5 603 853

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

46. Sa i takon mosdeklarimit sipas ligjit të huas, pakësimit të gjendjes *cash* në DPV-në për vitin 2016 dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huas, në parashtrimet e tij subjekti ka pretenduar se kjo është një pasaktësi në DPV-në e vitit 2016, e cila ka ndodhur për shkak se në janar të vitit 2017 subjekti kishte plotësuar deklaratën *Vetting*, ku e kishte deklaruar dhënien e huas. Sipas subjektit, kjo pasaktësi është rregulluar gjatë hetimit administrativ kur ka sqaruar se kjo shumë ka si burim nga kursimet e realizuara nga paga e tij dhe e bashkëshortes ndër vite, duke sjellë në vëmendje të Komisionit jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit:

Së pari, vendimin nr. 20, të datës 31.7.2019, në të cilin Kolegji i Posaçëm i Apelimit arsyeton se: “... mosdeklarimi prej subjektit të rivlerësimit i blerjes së automjetit në vitin 2005 është një pasaktësi e bërë në deklarin periodik të atij viti, i cili është ndrequr në vitin 2009, me vullnetin dhe iniciativën e vetë subjektit të rivlerësimit. Në këtë kuptim, kjo pasaktësi që i përket vitit 2005, e konsideruar si e tillë, nuk mund të shërbejë si një shkak i vetëm për të analizuar më tej drejt përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit”.

Së dyti, vendimin nr. 22/2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ku arsyeton se: “*Trupi gjykues, megjithëse e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se deklarinet periodike të subjektit kanë pasaktësi, vlerëson se bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, pasaktësitë në deklarinet periodike të pasurisë nuk përbëjnë shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore*”.

Siç duket, nga subjekti është pranuar pasaktësia në deklarinin për DPV-në e vitit 2016 për shkak të mosdeklarimit të pakësimit të likuiditetit *cash* për shkak të huas dhe burimit të kësaj huaje, por kjo pasaktësi sipas tij, është rregulluar gjatë procesit të rivlerësimit dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, kjo nuk mund të përbëjë shkak të veçuar për ta ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore.

46.1. Sa i takon këtyre pretendimeve të subjektit, nga Komisioni arsyetohet se:

Së pari: deklarimi në deklaratën *Vetting* (plotësuar në janar të vitit 2017) i burimit të huas të ardhurat nga paga ndër vite deklaruesit e bashkëshortes, nuk e përjashton subjektin nga detyrimi për deklarimin në DPV-në e vitit 2016 (plotësuar në mars të vitit 2017) të pakësimit të likuiditetit *cash* për shkak të dhënies së huas dhe burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e saj, ashtu sikurse neni 4 i ligjit nr. 9049/2003 i ndryshuar, e parashikon, si dhe nuk justifikon mungesën e deklarimeve në këtë deklaratë. Për më tepër, në deklaratën *Vetting* nuk rezulton që subjekti të ketë bërë ndonjë sqarim në lidhje me likuiditetet *cash* ndër vite me burim kursimet nga pagat, gjendjen e likuidimeve *cash* në fund të vitit 2015, të cilat kanë shërbyer për dhënien e huas apo pakësimin e tyre në vitin 2016 për shkak të dhënies së huas. Përkundrazi, në DPV-në për vitin 2015, subjekti deklaroi saktësisht gjendjen *cash* në këtë mënyrë: *gjendje cash, në vlerën 200,000 lekë të krijuar nga të ardhurat nga paga e deklaruesit dhe bashkëshortes*. Deklarimi i burimit të huas në deklaratën *Vetting: të ardhurat nga paga ndër vite deklaruesit e bashkëshortes*, nuk mund të përbejë provë që subjekti ka pasur kursime në formë likuiditetesh *cash* të akumuluar përgjatë viteve siç subjekti pretendon.

Së dyti, rasti i referuar nga subjekti, mosdeklarimi i blerjes së një automjeti në DPV-në e vitit 2005 nga një subjekt rivlerësimi, nuk mund të krahasohet me rastin e mosdeklarimit të pakësimit të gjendjes *cash* në DPV-në për vitin 2016 të subjektit Arben Dyla, për shkak të dhënies së huas. Nëse subjekti do të kishte deklaruar pakësim likuiditeti të gjendjes *cash* në DPV-në e vitit 2016 kur është dhënë huaja dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huas, sikurse ligji e kërkon, mund të vlerësohej që subjekti ka ndrequr pasaktësitë, të cilat pretendon të ketë kryer gjatë viteve në deklarimin *cash*, në raport edhe me rrethanat e tjera. Ndërsa, deklaratimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit nuk mund të konsiderohen si rregullime të gjendjeve *cash* sikurse subjekti pretendon, për më tepër që ato janë në disa raste kontradiktore me deklaratimet ndër vite dhe ato të dhëna gjatë pyetjes në ILDKPKI.

47. Subjekti ka parashtruar se mosdeklarimi i konvertimit të shumës prej 20,000 euro, në DPV-të vjetore ashtu edhe në ILDKPKI, nuk është as mospërputhje dhe as pasaktësi, pasi edhe Komisioni, kur paraqet analizat e tij financiare vlerën e pasurive e shpreh në monedhën lekë. Gjithashtu, subjekti pretendon se deklarimi i konvertimit nuk është kërkesë e ligjit. Sa i takon këtyre pretendimeve, nga Komisioni vlerësohet se formulari i deklarimit udhëzon se pasuritë mund të deklarohen në lekë apo valutë, udhëzim të cilin subjekti e ka pasur të qartë kur ka deklaruar huan e dhënë në shumën 50,000 euro. Megjithatë, në rastin e konvertimit të shumës 20,000 euro thelbi nuk është te deklarimi i kësaj shume në lekë apo në euro, por te fakti që sipas deklarimeve të subjektit në DPV-të e viteve 2003 – 2008, nuk ka pasur gjendje të akumuluar *cash* në shumën 20,000 euro apo 2,444,000 lekë²⁴ sikurse pretendohet prej tij dhe, për këtë arsye, shuma e mësipërme në lekë apo euro nuk konsiderohet si gjendje *cash* faktike e subjektit në fund të vitit 2008.

48. Subjekti ka prapësuar se në DPV-të ndër vite, ai ka deklaruar shtesa nga viti në vit dhe jo gjendjen e likuiditetit *cash* në fund të çdo viti, pasi ka pasur si qëllim blerjen e një apartamenti dhe për këtë arsye ka kursyer çdo vit. Subjekti prapëson se deklarimi i shtesave të likuiditeteve vit pas viti dhe vetëm në një vit deklarimi i pakësimit, është i logjikshëm dhe përputhet me logjikën e ligjit dhe formularit. Sipas

²⁴Shihni akteksptimin të paraqitur nga subjekti me parashtrimet e tij, analiza e vitit 2008, f. ***.

subjektit, deklaramet në ILDKPKI, si dhe gjatë hetimit administrativ, përputhen me qëllimin e tij për kursim. Subjekti vazhdon të pretendojë se te *gjendja cash* deklaruar në DPV-të, janë përfshirë shtesat e likuiditeteve *cash* dhe në bankë, duke sjellë në vëmendje se shumë shpesh nga subjektet koncepti i fjalës *cash* ngatërrohet me konceptin e fjalës likuiditet.

48.1 Sa i takon këtyre pretendimeve të subjektit nga Komisioni arsyetohet se:

Së pari: subjekti ka deklaruar shprehimisht dhe në të njëjtën mënyrë *gjendjen cash* në DPV-të për vitet 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2012, 2013, 2014 dhe 2015. Ndërkohë që, në DPV-në e vitit 2010 ka deklaruar sipas kërkesave të ligjit *shtuar gjendje cash*, duke deklaruar saktësisht shtesën prej 700,000 lekësh mbi *gjendjen cash 700,000 lekë* të deklaruar në DPV-në e vitit 2009 dhe kështu, në fund të vitit 2010 *gjendja cash* ka qenë 1,400,000 lekë. Ndërsa, në DPV-në e vitit 2011 ka deklaruar sipas ligjit *pakësime: gjendja cash që disponohet nga personi*, duke deklaruar saktësisht pakësimin të *gjendjes cash* në shumën prej 700,000 lekësh, ku *gjendja cash* në fund të të cilit mbeti 700,000 lekë.

Pretendimi i subjektit se shumata e deklaruara në çdo vit janë shtesa likuiditetesh dhe jo *gjendja cash* mbetet në nivel deklarativ përderisa në dy nga DPV-të subjekti ka deklaruar shtesa dhe pakësime. Ndërsa pretendimi se shprehja e togfjalëshit *gjendje cash* ka qenë për shkak se nuk ka kuptuar saktë ligjin, është i pabesueshëm përderisa në deklaramet periodike të dy viteve, subjekti ka kryer deklarimin sipas ligjit saktësisht të shtesës dhe pakësimin të likuiditeteve *cash*. Nëse subjekti do të ishte i njëtrajtshëm në deklarime duke shprehur në çdo vit *gjendjet cash*, vetëm atëherë mund të vleresohej nëse subjekti ka qenë në kushtet e një pasaktësie për shkak të moskuptimit të mënyrës së deklarimit, sigurisht duke pasur në konsideratë edhe rrethanat të tjera të çështjes. Veç sa më sipër, u vërtetua se subjekti ka qenë në disa raste kontradiktor në deklarime për shkak të mospërputhjes së deklarameve në DPV krahasuar me ato të dhëna në ILDKPKI dhe ato gjatë procesit të rivlerësimit.

Së dyti: për vitin 2004 subjekti ka deklaruar “*gjendje cash në shumën 8.000 USD*”, e cila përputhet me deklarimin e bërë prej tij në shkurt të vitit 2016 në ILDKPKI, ku subjekti ka deklaruar se shuma 8.000 USD përfshin edhe kursimet *cash* të vitit 2003, gjë e cila nënkupton se *gjendja* në fund të vitit 2004 është 8,000 USD. Ndërkohë që, në pyetësin nr. 2 dhe në parashtrimet e tij, subjekti deklaroi se ka shtuar vlerën 8,000 USD mbi *gjendjen cash* në fund të vitit 2003, e cila ishte 450,000 lekë, çka e bën këtë deklaram të kryer për efekt të procesit dhe subjekti nuk mund të zëvendësojë deklaramet mbi *gjendjen cash* të kryera edhe në kohë reale (viti 2004) dhe të përsëritura në ILDKPKI (viti 2016).

Së treti, sipas DPV-së së vitit 2016, *gjendja cash* deklaruar: në pronësi: likuiditet. *Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga e deklaruesit dhe bashkëshortes* është në vlerën 300,000 lekë, ndërsa sipas parashtrimeve të tij, *gjendja cash* në datën 31.12.2016 (që do të thotë mbetja e likuiditetit *cash* pas dhënies së huas prej 50,000 euro) është 1,342,442 lekë (517,972 lekë, 8,000 USD dhe 83 euro). Ndërkohë, në datën 26.1.2017, kur është plotësuar deklarata *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar likuiditet në *gjendje cash* dhe brenda kësaj periudhe nuk rezulton të ketë kryer ndonjë investim. I pyetur në seancën dëgjimore në lidhje me shpenzimin e kësaj shume, subjekti u shpreh se nuk mbante mend se si e kishte shpenzuar.

Së katërti, sa i takon pretendimit se subjekti ka deklaruar likuiditetet së bashku (*gjendje cash* në shtëpi dhe *gjendjen* në bankë), duke argumentuar se *shumë shpesh koncepti i fjalës cash ngatërrohet me*

konceptin e fjalës likuiditet, nuk qëndron pasi: (i) formulari i deklarimit periodik është shumë i qartë dhe specifikon se çfarë lloj pasurish duhen deklaruar²⁵; (ii) në DPV-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar edhe gjendjen *cash* edhe një depozitë kursimi në emër të bashkëshortes në “Raiffeisen Bank”; gjithashtu për vitet 2015 dhe 2016 ka deklaruar përkatësisht edhe gjendjen *cash* edhe gjendjen e llogarisë së tij të pagës në “Raiffeisen Bank”. Në këtë rast, deklaramet e subjektit nuk janë kryer nën të njëjtën qasje logjike, pasi subjekti e ka kuptuar mënyrën e deklarimit të likuiditeteve të ndara në *cash* dhe në bankë, duke e reflektuar këtë në deklarimin e tij për vitin 2014 e në vijim, por nuk ka kryer asnjë deklaramet saktësues për vitet para DPV-së së 2014, gjë që e ka bërë vetëm kur është pyetur nga ILDKPKI-ja, në shkurt të vitit 2016.

48.2. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, në kushtet kur shpjegimet e subjektit mbi gjendjen e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar bien ndesh me deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaramet e interesave private periodike vjetore, të cilat konsiderohen si provë shkresore parësore, në zbatim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe së bashku me deklarametën *Vetting* përbëjnë të vetmen mënyrë verifikimi të ekzistencës së pasurisë “likuiditet në *cash*” në funksion të procesit të rivlerësimit, si dhe në kushtet kur ka pasur në disa raste mospërputhje dhe qëndrime kontradiktore me faktet dhe rrethanat sa i takon likuiditeteve *cash*, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vlera *cash* jashtë sistemit bankar në vite ka shërbyer për dhënien e huas në vlerën 50,000 euro, mbeten në nivel deklarametiv dhe jo të besueshme²⁶.

Bazuar në sa më sipër, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes Komisioni çmoi se:

- i) shumat e deklarametara në DPV-të, ndër vite, të konsiderohen si gjendje të atij viti dhe jo shtesa;
- ii) shumat *cash* të deklarametara në DPV-të, ndër vite, do të konsiderohen si *cash* në banesë dhe jo si shumatore të likuiditeteve *cash* dhe në bankë, pasi duke filluar nga deklarimi i vitit 2014, subjekti ka deklaruar gjendje depozitash në bankë veçmas gjendjeve *cash*, gjë që kundërshton moskuptimin e nocionit të likuiditetit nga ana e tij;
- iii) asnjë shumë tjetër shtesë e prezantuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe në parashtrimet e subjektit si gjendje likuiditeti nuk u konsiderua në analizën financiare.

49. Sa i takon mbajtjes së kursimeve jashtë sistemit bankar, subjekti pretendon se meqenëse ka pasur si qëllim porositjen apo blerjen e një apartamenti i ka mbajtur kursimet në shtëpi me qëllim që në rastin më të parë të kishte mundësi të porositte apartamentin duke paguar ndoshta këstin e parë. Sa i takon këtij pretendimi, çmohet jobindës pasi mbajtja e kursimeve në sistemin bankar nuk do ta kishte penguar subjektin t’i përdorte paratë e tij në çdo kohë, kur do të kishte nevojë.

50. Sa i takon analizës financiare, subjekti ka paraqitur një aktekspertim kontabël të përgatitur nga shoqëria audituese “A. M.” sh.p.k., i cili kundërshton rezultatin e Komisionit në lidhje me situatën e gjendjes *cash*, e cila e përlllogaritur në analizën financiare të ekspertit kontabël është paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese.

²⁵Në formularin e deklarimit periodik shënohet: “Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesat dhe pakësimet)” të çdolloj pasurie ndër të cilat përfshihen edhe ...blera e likuiditeteve si në gjendje *cash*, në depozitë, në bono thesari etj.”.

²⁶Për më tepër referojuni vendimit (JR) nr. 27/2020.

Vitet	Shtesa/pakësime likuiditetesh ²⁷ gjatë vitit (në lekë)	Gjendja në fund të çdo viti (në monedhë origjinale)	Gjendja e akumuluar në fund të çdo viti (në lekë)
2003	450 000	450 000 lekë	450 000
2004	8 000 USD	450 000 lekë / 8 000 USD	1 206 640
2005	750 000	1 200 000 lekë / 8 000 USD	1 920 000
2006	250 000	1 450 000 lekë / 8 000 USD	2 170 000
2007	700 000	2 150 000 lekë / 8 000 USD	2 870 000
2008	600 000	306 000 lekë / 8 000 USD / 20 000 euro	3 470 000
2009	700 000	1 006 000 lekë / 8 000 USD / 20 000 euro	4 170 000
2010	700 000	1 706 000 lekë / 8 000 USD / 20 000 euro	4 870 000
2011	-700 000 + 89 388*	1 095 388 lekë / 8 000 USD / 20 000 euro	4 259 388
2012	600 000 + 36 418 ²⁸	1 731 806 lekë / 8 000 USD / 20 000 euro	4 895 806
2013	600 000 + 28 426*	2 360 232 lekë / 8 000 USD / 20 000 euro	5 524 232
2014	700 00 + 110 000 ²⁹	3 170 232 lekë / 8 000 USD / 20 000 euro	6 334 232
2015	200 000 + 600 000 ³⁰	3 970 232 lekë / 8 000 USD / 20 000 euro	7 134 232
2016	717 210 ³¹	517 972 lekë / 8 000 USD / 83 euro	1 342 442

Shumat e shënuara me shenjen* janë prezantuar për herë të parë në aktekspertimin e datës 10.7.2021, pa u sqaruar se çfarë përfaqësojnë.

50.1. Në analizën financiare të subjektit, në të cilën nuk rezultojnë balanca negative, vërehet se:

i) Shumat e deklaruara si gjendje *cash* në fund të çdo viti janë konsideruar si shtesa likuiditetesh. Sipas aktekspertimit, në momentin e dhënies së huas z. Arben Dyla ka pakësuar gjendjen e likuiditeteve prej 50,000 euro ose 6,509,000 lekë, e cila ka ardhur si rezultat i shumës 20,000 euro të mbartur nga viti 2009 dhe 30,000 euro ose 4,065,000 lekë të konvertuara në vitin 2016. Siç u arsyetua më sipër, kjo gjendje likuiditeti në momentin e dhënies së huas nuk bazohet në deklaratimet në deklaratat periodike vjetore dhe, për rrjedhojë, përllogaritjet e subjektit nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni.

ii) Subjekti ka kundërshtuar përllogaritjen e të ardhurave nga paga, si dhe shpenzimet e jetesës. Konkretisht, metodologjia e përdorur në këtë analizë ndjek atë të përdorur nga Komisioni, por duke përllogaritur rezultatin e çdo viti kalendarik të barabartë me 0 (zero)³². Sa i takon të ardhurave nga paga e subjektit dhe bashkëshortes ndër vite, në analizën financiare të ekspertit kontabël janë përfshirë të ardhura *bruto* dhe dietat (për subjektin). Sa i takon shpenzimeve të jetesës, analiza financiare e ekspertit kontabël ka ndjekur metodologjinë e përllogaritjes së këtyre shpenzimeve si diferencë aritmetike e të

²⁷Eksperti përfshin tek likuiditetet gjendjen *cash* në shtëpi dhe likuiditet në bankë.

²⁸Kjo shumë përfaqëson vetëm gjendjen e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në datën 31.12.2012, në “Raiffeisen Bank” dhe nuk është deklaruar dhe as përmendur në DPV-në e vitit 2012.

²⁹Në DPV-në e vitit 2014 është deklaruar: gjendje *cash* 700,000 lekë dhe 110,000 lekë depozitë kursimi me afat 2-vjeçare në “Raiffeisen Bank”.

³⁰Në DPV-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar: gjendje *cash* 200,000 lekë dhe 600,000 lekë gjendje në llogarinë e tij të pagës tek “Raiffeisen Bank”.

³¹Në prapësimet e tij subjekti deklaron se në vitin 2016 ka deklaruar këtë shtesë. Referuar DPV-së së vitit 2016 subjekti ka deklaruar: gjendje *cash* 300,000 lekë dhe 100,000 lekë gjendje në llogarinë e tij të pagës.

³²Aktekspertimi presupozon që të ardhurat e përfituara brenda një viti janë shpenzuar tërësisht për pasuritë dhe shpenzimet e evidentuara; ajo çka mbetet janë shpenzimet e jetesës. Në këtë mënyrë rezultati në fund të viti kalendarik është 0 (zero).

ardhurave me pasuritë dhe shpenzimet e tjera të evidentuara³³. Sipas kësaj metodologjie rezulton që subjekti të ketë shpenzuar për të jetuar çka i ka mbetur nga të ardhurat e tij, pasi ka krijuar pasuritë, likuiditetet dhe ka kryer disa shpenzime të tjera të evidentuara.

Në analizë të këtyre pretendimeve, nga Komisioni janë verifikuar edhe një herë të ardhurat e dokumentuara nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes³⁴ dhe lëvizjet e llogarive bankare ku kanë kaluar këto paga. Në përfundim, Komisioni ka kryer korrigjimet e nevojshme, ku pagat janë konsideruar *neto* dhe dietat nuk janë përfshirë tek të ardhurat bazuar në qëndrimin e qartë të Kolegjit për këtë çështje³⁵.

Sa i takon shpenzimeve të jetesës dhe pa hyrë në krahasimin numerik midis shpenzimeve të jetesës, të përlllogaritura nga eksperti kontabël dhe atyre të përdorura gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni ndjek një metodologji të unifikuar, e cila në rastin e shpenzimeve të jetesës bazohet në ato të përlllogaritura nga INSTAT-i sipas përbërjes familjare të subjektit dhe që përbëjnë edhe standardin e përdorur nga ILDKPKI-ja.

50.2. Bazuar në sa është arsyetuar në këtë vendim, në përfundim, Komisioni çmoi se subjekti: (i) nuk ka deklaruar sipas ligjit pakësim të gjendjes *cash* në DPV-në e vitit 2016 për shkak të dhënies së huas prej 50,000 euro dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huas; (ii) nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme huan e dhënë në dhjetor të vitit 2016 huamarrësit A. K., për shkak të një balance negative në vlerën 5,233,649 leke³⁶, duke qenë në kushtet e pasaktësisë dhe pamjaftueshmërisë në deklarime sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, i cili e parashikon këtë si shkak për shkarkimin e subjektit nga detyra.

51. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar në pronësi automjetin tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 1994, i blerë me kontratën e shitjes së automjetit nr. ***, datë 21.12.2006, në vlerën 500,000 lekë. Zotërimi: 100 %. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga. Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar se: (i) subjekti nuk ka kryer regjistrimin e automjetit në pronësinë e tij në DPSHTRR, i cili rezulton ende në emër të shitësit; dhe (ii) nuk është e qartë arsyeja e mosregjistrimit të automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa TR ***, nga subjekti në pronësi të tij që nga viti 2006.

52. Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

52.1 Gjatë hetimit administrativ, DPSHTRR-ja³⁷ nuk konfirmoi që ky automjet të jetë regjistruar në pronësi të subjektit. I pyetur mbi mosregjistrimin e automjetit, subjekti sqaroi³⁸ se kjo ka ndodhur për shkak të ngarkesës në punë, si dhe për shkak se gjatë kësaj periudhe, duke qenë drejtues i Prokurorisë së Rrethit Mat, ka pasur në përdorim automjetin e institucionit dhe nuk ka pasur nevojë për përdorimin e automjetit, i cili ka dalë nga qarkullimi në datën 30.7.2019³⁹. Nga deklaratimet në DPV-të për vitet

³³Këtu përfshihen të gjitha shpenzimet e përlllogaritura nga Komisioni: shpenzimet e udhëtimit *TIMS*, shpenzimet e transportit nga banesa në punë, shpenzime zhdoganimit të automjetit, shpenzime mobilimi dhe shpenzime shkollimi.

³⁴Shihni vërtetimet e pagave në aneksin 4/5, të administruara në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁵Shihni vendimin nr. 7/2019, datë 5.4.2019, paragrafi 39, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

³⁶Balanca negative ndryshoi nga -5,603,853 lekë në -5,233,649 lekë, pas marrjes në konsideratë të disa nga pretendimeve të subjektit në lidhje me të ardhurat e tij.

³⁷Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.5.2020, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

³⁸Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

³⁹Shihni vërtetim nr. *** prot., datë 30.10.2019, lëshuar nga DPSHTRR-ja sipas të cilit vërtetohet se automjeti me targa TR ***, i markës “Mercedes-Benz” është hequr nga qarkullimi në datën 30.7.2019, për arsye jashtë përdorimi sipas kërkesës së aplikantit A. D. dhe është kryer pagesa e çregjistrimit nga subjekti Arben Dyla, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

2005, 2006 dhe 2007 vërehet se subjekti në këto vite ka ushtruar detyrën e kryeprokurorit të Prokurorisë së Rrethit Mat.

52.2. Nga aktet në dosjen e ILDKPKI-së⁴⁰, në lidhje me këtë automjet, u konstatua se kontrata nr. ***, datë 11.2.2006, është lidhur midis shtetasit A. N. D. në cilësinë e shitësit dhe subjektit Arben Dyla në cilësinë e blerësit. Objekt i kësaj kontrate është shitblerja e automjetit tip HO, marka “Mercedes-Benz”, shasia nr. ***, me targa TR ***, viti i prodhimit 1994, me çmim 500,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Ky automjet është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2006 me të njëjtin çmim, por pa deklaruar burimin e krijimit sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

52.3. Në lidhje me shtetasin A. N. D. janë kryer verifikime në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi, nga ku sipas informacionit të dërguar nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan⁴¹, Mat⁴² dhe Lushnjë⁴³, nuk rezulton që ky shtetas të ketë qenë kallëzues, person nën hetim, i pandehur apo i dyshuar/kallëzuar në kallëzime/procedime penale të shqyrtuara nga prokurori Arben Dyla, si dhe as procedime penale⁴⁴ të regjistruara në emër të tij.

53. Në lidhje me burimin e krijimit të këtij automjeti, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat nga pagat. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti ka pasur mundësi për blerjen e kësaj pasurie.

Përshkrimi	11.2.2006
Pasuri	53 248
Automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa TR ***	500 000
<i>Shtesa/pakësime/likuiditete</i>	-446 752
Likuiditete/gjendje	815 496
Të ardhura dokumentuar	203 139
Të ardhura nga paga e subjektit	203 139
Shpenzime	14 352
Shpenzime jetese	12 306
Shpenzime transporti sipas pyetësorit nr. 2	2 045
Mundësia për kursime	135 539

54. Nga verifikimi në sistemin AMF-së, u konstatua se këtë automjet e kanë pasur në cilësinë e pronarit dhe përdoruesve shtetasit K. dhe E. B.. I pyetur mbi marrëdhëniet me këta shtetas, subjekti ka informuar se⁴⁵ shtetasi K. B. është daja e tij (vëllai i nënës), ndërsa shtetasi E. B., është djali i dajës. Më tej, subjekti informon se përpara vitit 2015, këtë automjet (me targa TR ***), duke qenë se qëndronte i parkuar në shtëpinë e dajës, e ka përdorur ndonjëherë për nevoja familjare, ndërsa pas vitit 2015 ia ka lënë në përdorim verbalisht dajës së tij, i cili e përdorte për të shoqëruar djalin e tij (subjektit) në shkollë, në kolegjin “T. O.” Durrës. Nga viti 2017 dhe në vijim pas largimit për në Tiranë, ky

⁴⁰Shihni aktet në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** port., datë 11.5.2021, nga Prokuroria e rrethit Elbasan, në dosjen e Komisionit.

⁴²Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 7.5.2021, në dosjen e Komisionit.

⁴³Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në dosjen e Komisionit.

⁴⁴Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

⁴⁵Shihni përgjigjet e subjektit dërguar në rrugë elektronike në datën 21.6.2021, në dosjen e Komisionit.

automjet i është lënë në përdorim dajës dhe djalit të tij me qëllim për t'i shërbyer dy prindërve të tij pensionistë për nevojat e tyre familjare. Ndërkohë, ky automjet është marrë nga subjekti në vitin 2019, kur është nxjerrë jashtë përdorimit duke e shitur për skrap. Nga verifikimet e kryera në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi në lidhje me këta shtetas, nuk kanë rezultuar të dhëna⁴⁶.

55. Subjekti ka deklaruar në pronësi automjetin tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2003, i blerë sipas deklaratës së shitjes datë 3.12.2010, në vlerën 8,000 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga. ILDKPKI-ja ka konstatuar se automjeti tip “Mercedes-Benz” me targa AA *** është deklaruar nga subjekti në deklaratën e interesave private të vitit 2011 dhe jo në vitin 2010.

56. Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

56.1 Nga aktet në dosjen e ILDKPKI-së⁴⁷ u konstatua se sipas deklaratës së shitjes së përpiluar në datën 3.12.2010, në Romë, Itali, pala shitëse, shtetasi L. C., deklaroi t'i ketë shitur verbalisht subjektin të rivlerësimit Arben Dyla automjetin me targa ***, për çmimin 8,000 euro pa TVSH. Ndërkohë, zhdoganimi është bërë në datën 20.6.2012, pra, afërsisht pas 1 viti e gjysmë 5. I pyetur mbi këtë fakt, subjekti sqaroi se⁴⁸ me shtetasin L. C. kishte rënë dakord në rrugë telefonike (pasi ky shtetas ndodhej në Itali), për blerjen e automjetit në çmimin e shitjes prej 8,000 euro, mjet që asokohe ndodhej në Shqipëri në ruajtje të shtetasit A. H. dhe shitja do të konkretizohej në momentin që ky shtetas do të dorëzonte automjetin të riparuar nga një defekt në pjesën e kamios. Më tej, subjekti informon se automjetin me targa *** e ka marrë nga shtetasi A. H., jo plotësisht të rregulluar nga defekti në kamio, në fund të vitit 2011, ndërkohë që në fillim të vitit 2011 e kishte karamboluar duke i dëmtuar pjesën ballore dhe, për këtë arsye, riparimi i plotë i tij nga shtetasi A. H. ka zgjatur mbi 10 muaj. Ndërkohë, zhdoganimi i automjetit është kryer pas disa muajsh duke qenë se pas muajve prill dhe maj doganat publikonin çmimet e reja të referencës për zhdoganimin e automjeteve.

Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur⁴⁹: (i) deklaratë noteriale nr. ***, datë 17.6.2021, të shtetasit L. Ç.; (ii) deklaratë noteriale nr. ***, datë 17.6.2021, të shtetasit A. H., si dhe deklaroi se është i gatshëm që automjeti të këqyret nga një grup ekspertësh autoteknikë për verifikimin e dëmtimeve dhe kohën e tyre.

56.2. Gjatë hetimit administrativ DPSHTRR-ja⁵⁰ ka konfirmuar se shtetasi Arben Dyla ka të regjistruar në pronësi automjetin me targa *** dhe është bashkëngjitur dokumentacioni: (i) certifikata e pronësisë nr. *** të automjetit me targa *** në pronësi të shtetasit L. C.; (ii) deklaratë shitjeje, datë 3.12.2010, nga shtetasi L. C., në Romë, i cili deklaroi se i ka shitur verbalisht automjetin tip “Daimler Chrysler”, nr. identifikimi ***, subjektin Arben Dyla; (iii) leje qarkullimi italiane nr. ***; (iv) akti i zhdoganimit, datë 20.6.2012, nga dërguesi Arben Dyla Itali në vlerën 237,825 lekë; (v) lejeqarkullimi FR ***, datë

⁴⁶Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 21.6.202, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë; si dhe shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁴⁷Shihni aktet në aneksin nr. ***, në dosjen e administruar nga ILDKPKI-së.

⁴⁸Shihni përgjigjet e subjektit dërguar në rrugë elektronike në datën 21.6.2021, në dosjen e Komisionit.

⁴⁹Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 4, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 23.6.2021, në dosjen e Komisionit.

⁵⁰Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.5.2020, nga DRSHTRr-ja, administruar në dosjen e Komisionit.

9.10.2013; (vi) certifikatë e kontrollit fizik, datë 9.10.2013; (vi) urdhër çlirimi nr. ***, nga Drejtoria e Doganave.

57. Në lidhje me burimin e krijimit

Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim të ardhura nga pagat. Pasi u verifikuan të ardhurat e dokumentuara nga pagat, u krye analiza financiare në momentin e pagimit të çmimit si vijon:

Përshkrimi	3.12.2010
PASURI	1 707 089
Automjet "Mercedes-Benz", me targa ***	1 110 480
<i>Shtesa/pakësime/likuiditete</i>	596 609
Likuiditete/gjendje	1 700 494
TË ARDHURA dokumentuar	1 676 069
Të ardhura nga paga e subjektit	1 259 178
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	416 891
SHPENZIME	539 326
Shpenzime jetese për 3 persona	378 419
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	4 841
Shpenzime transporti sipas P.2	156 067
Mundësia për kursime	-570 347

57.1. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë sqarime dhe prova për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve, ku duket se:

- nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit, për shkak të një balance negative në shumën 570.347 lekë;
- në DPV-në e vitit 2010 subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri, ndërkohe që e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2011 me të njëjtin çmim blerjeje, por pa deklaruar burimin e krijimit, sipas ligjit.

58. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

58.1 Në parashtrime, subjekti ka pretenduar se automjeti është blerë në vitin 2011 dhe e ka marrë në dorëzim, si dhe ka paguar vlerën e 8,000 euro për blerjen e tij, por nuk ka paraqitur ndonjë provë për të vërtetuar këtë fakt. Subjekti ka vijuar të japë të njëjtat deklarata me ato të dhëna gjatë procesit administrativ, duke theksuar edhe një herë që automjeti është riparuar nga shtetasi A. H., i cili e kishte në ruajtje dhe nëse Komisioni ka dyshime, mund të këqyr automjetin.

Për të vërtetuar këto pretendime janë paraqitur dokumentet: (i) deklaratë noteriale nr. ***, datë 14.7.2021, të shtetasit E. K., në të cilin konfirmon deklaratimet e subjektit gjatë procesit, ku i ka sugjeruar subjektit që zhdoganimin ta bënte në qershor të vitit paraardhës, pra, në vitin 2012, duke qenë se në këtë periudhë autoritetet doganore publikonin çmimet e reja të referencës për zhdoganimin e automjeteve që mund të rezultonin më të favorshme për pronarin e automjetit; (ii) të dhëna nga sistemi *TIMS* për shitësin L. C., sipas të cilave ky shtetas ka dalë nga Shqipëria në datën 12.11.2009 dhe ka

hyrë përsëri në Shqipëri më 7.11.2012, gjë që vërteton se ka qenë në Itali kur është hartuar deklarata e dorës për shitjen e automjetit, sikurse deklaroi subjekti.

Në konkluzion, subjekti pretendon se çmimi për blerjen e automjetit është paguar në vitin 2011 dhe, për këtë shkak, është deklaruar prej tij në DPV-në e vitit 2011, ashtu sikurse konfirmohet edhe nga deklarata noteriale e shtetasit A. H., paraqitur në përgjigje të pyetësorit nr. 4.

58.2. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi të marrë në konsideratë pretendimet e subjektit dhe vlerësoi që çmimi i automjetit nuk është paguar më 3.12.2010, por në vitin 2011, duke marrë në konsideratë rrethanat dhe faktet si vijojnë: (i) deklarin e automjetit në DPV-në e vitit 2011; (ii) faktin që zhdoganimi i automjetit është bërë në qershor të vitit 2012, periudhë e cila është shumë më afër vitit 2011, kur pretendohet se është paguar shuma 8,000 euro; (iii) fakti që subjekti e ka deklaruar pagesën e çmimit në vitin 2011, pra, para se t'i dërgohen rezultatet e hetimit, i cili është një tregues që pretendimet e tij nuk janë ndikuar nga rezultati negativ i përllogaritur në analizën financiare të datës 3.12.2010. Në përfundim, shpenzimi për blerjen e automjetit në shumën prej 8,000 euro, është përfshirë si shpenzim në analizën financiare për vitin 2011, vit në të cilin, sipas analizës përfundimtare të rishikuar, subjekti rezulton me balancë pozitive.

59. Subjekti ka deklaruar në përdorim, apartament banimi me sip 150 m², e lënë si garanci nga shtetasi A. K. për shlyerjen e kontratës së huas me garanci nr. ***, datë 21.12.2016, trajtuar në pikën 1 të këtij materiali.

Përveç verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të në deklaratën Vetting, Komisioni kreu hetime në lidhje me konstatimet si vijojnë:

60. Në DPFD-në e vitit 2003 deri në DPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar si adresë lagjja nr. 4, Kavajë. Në lidhje me këtë adresë, në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se ka banuar me prindërit, por nuk ka specifikuar që kjo adresë është në pronësi të tyre. Referuar përvojës profesionale, në periudhën 2003 – 2008, subjekti ka qenë me funksion prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat dhe sipas pyetësorit nr. 1, ka jetuar pjesërisht me prindërit në apartamentin në pronësi të tyre në Kavajë dhe 2-3 ditë në javë në qytetin e Burrelit, ndërkohë që në periudhën 2008- 2011, ka qenë me funksion prokuror në Prokurorinë Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe ka deklaruar se ka jetuar me prindërit dhe bashkëshorten në apartamentin në pronësi të tyre në Kavajë.

Gjatë hetimit administrativ, ASHK-ja Kavajë⁵¹ ka konfirmuar se në pronësi të prindërve të subjektit B. dhe L. D., figuron pasuria e paluajtshme - *apartament me sip. 77 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. *** me adrese: lagjja nr. ***, p. ***, sh. ***, ap. ***, Kavajë* - e përfituar me anë të aktit kontrate për privatizimin e banesës, lidhur në datën 8.9.1993, me Ndërmarrjen Komunale Banesa. Përputhen deklarinimet e subjektit me dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ dhe duke qenë se pasuria është përfituar nga privatizimi, nuk ka pasur vend për verifikime të mëtejshme.

⁵¹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 29.5.2020, nga ASHK-ja Kavajë.

61. Në DPV-në 2012 – 2013, subjekti ka deklaruar adresën e gjendjes civile “*Lagjja ‘Xh. N.’ Lushnjë*”.

Gjatë hetimit administrativ, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me pronësinë e pasurisë në këtë adresë dhe nëse ka banuar ndonjëherë në të. Në përgjigjet të pyetësorëve nr. 2 dhe 3, subjekti sqaroi se me këtë adresë ka bërë regjistrimin formal në Gjendjen Civile Lushnjë, pasi bashkëshortja punonte në Lushnjë dhe *ishte shantazhuar disa herë me largim nga puna, duke mos qenë banore e qytetit të Lushnjës*. Sipas subjektit, banesa në lagjen “Xh. N.”, Lushnjë, pasuria me nr. ***, ka qenë në pronësi të shtetasve A. dhe E. Sh., vërtetuar me vërtetim nga dokumentet hipotekore lëshuar në datën 18.12.2012. Ndërsa sa i takon dokumenteve që kanë shërbyer për regjistrimin në Gjendjen Civile, subjekti ka paraqitur: (i) kërkesë për lejebanimi drejtuar Gjendjes Civile Lushnjë, datë 23.1.2013; (ii) deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.1.2013, në të cilën subjekti Arben Dyla ka deklaruar se banon me qira në adresën lagjja “Xh. N.”, Lushnjë, në apartamentin nr. ***, në pronësi të shtetasit A. Sh..

Në përfundim të hetimit administrativ nuk rezultuan të dhëna që subjekti të ketë banuar realisht në adresën, “*lagjja ‘Xh. N.’, Lushnjë*” deklaruar si adresë e Gjendjes Civile në DPV-në 2012-2013, por kjo adresë është përdorur prej tij për regjistrimin në gjendjen civile në fillim të vitit 2013.

62. Në DPV-në për vitin 2012, subjekti ka deklaruar adresë vendbanimi: “*Kavajë, Lagjja nr. ****”. Në këtë periudhë subjekti ka qenë me funksion prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Lushnjë.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se: “*Në mesin e vitit 2012, së bashku me bashkëshorten A. D. dhe djalin A. D., kam jetuar në një apartament të cilin ma ka lënë në përdorim pa qira, miku im B. M.. Këtë apartament e kam përdorur pa qira deri në muajin janar të vitit 2017*”. Për të vërtetuar këtë deklaram, subjekti ka paraqitur deklaratë noteriale nr. ***, datë 4.4.2016, lëshuar nga shtetasi B. M., i cili konfirmon deklaramet e subjektit.

Referuar pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, shtetasi F. M., i cili i ka dhënë në huapërdorje subjektit një apartament banimi për një afat prej 5-vjeçar, gjatë periudhës së rivlerësimit, është konsideruar si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit. Me qëllim evidentimi të çdollos lidhjeje të subjektit me këtë pasuri, si dhe mënyrën e përfitimit të saj nga shtetasi F. M., janë kryer verifikimet e mëposhtme:

62.1. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, i pyetur mbi arsyet e dhënies pa qira të saj për një periudhë 5-vjeçare, si dhe të paraqesë dokumente që vërtetojnë pronësinë e shtetasit B. M., subjekti sqaroi se me këtë shtetas kishte pasur një miqësi të vjetër dhe, për këtë arsye, i kishte lënë në përdorim pa qira apartamentin në fjalë, i cili është regjistruar në emër të z. F. M., vëllai i B. M.. Sipas tij, z. F. M., kishte në pronësi 3 apartamente në pallatin e ndërtuar nga shoqëria “Sh.” sh.p.k. dhe deri më 1.11.2016, akoma dy prej tyre nuk ishin shitur dhe ishin te pabanuara. Nga këto apartamente, njeri i është dhënë për përdorim pa shpërblim subjektit. Në lidhje me librezat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të këtij apartamenti, subjekti ka deklaruar se nuk i disponon ato, pasi në kohën e përdorimit të tij librezat e ujit dhe energjisë elektrike vinin në emër të shoqërisë ndërtuese të pallatit dhe se pronarët e apartamenteve akoma nuk kishin lidhur kontrata individuale për furnizimin e me ujë dhe energji elektrike.

Për të vërtetuar pretendimet e tij subjekti ka paraqitur: (i) shkresë nr. *** prot., datë 1.11.2016, nga ZVRPP-ja Kavajë, drejtuar subjektit, sipas të cilës shtetasi F. Xh. M. ka të regjistruara tri apartamente

me sip, 84.8 m², sip.115.8 m² dhe sip. 89.8 m²; (ii) ekstrakt historik të shoqërisë “F.” sh.p.k., sipas të cilës z. F. M. është administrator i saj.

62.2. Subjektit iu rikërkua informacion për mënyrën e lejitimit të përdorimit e këtij apartamenti, arsyen e dhënies së apartamentit në përdorim pa qira për një periudhë 5-vjeçare nga shtetasi F. M., si dhe të vërtetohet me dokument faktin që apartamenti i tij ndodhet në adresën, *Lagjja nr. ***, Kavajë*, të cilën e kishte deklaruar si adrese vendbanimi. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti vijoi të sqarojë se ka banuar në apartamentin me nr. pasurie ***, në Kavajë, në pronësi të shtetasit F. M., pasi ky i fundit kishte rënë dakord verbalisht me vëllain e tij B. M., që apartamenti të përdorej pa qira nga subjekti, duke qenë se ishte në gjendje të mirë ekonomike dhe nuk kishte nevojë për të ardhurat që mund të siguronte nga qiradhënia apo shitja. Ndërkohë, sqaron se që ky apartament është shitur, pasi subjekti është larguar prej aty. Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur të njëjtat akte të paraqitura në përgjigje të pyetësorit nr. 2, duke shtuar: (i) deklaratën noteriale nr. ***, datë 3.6.2021, të shtetasit F. M., në të cilin ky shtetas ka konfirmuar faktin që z. Arben Dyla ka jetuar pa qira në periudhën 2012 – 2016, në njërin prej apartamenteve e tij të ndërtuara shoqëria “Sh.” sh.p.k. në lagjen nr. ***, Kavajë, të cilin e ka shitur pas largimit të subjektit; kartela të pesë pasurive në pronësi të shtetasit F. M..

62.3. ASHK-ja Kavajë⁵² nuk ka konfirmuar pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë në Kavajë.

62.4. FSHU-ja⁵³ nuk ka konfirmuar kontrata të furnizimit me energji në emër të shtetasit Arben B. Dyla dhe të bashkëshortes apo prindërve në instancën e Kavajas. Pas kërkesës së Komisionit, FSHU-ja⁵⁴ ka informuar se në emër të shtetasit F. Xh. M. ka tri kontrata furnizimi me energji në instancën Kavajë.

62.5. Në lidhje me shtetasin B. M. janë kryer verifikime në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi. Sipas informacionit të dërguar, nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan⁵⁵, Mat⁵⁶ dhe Lushnjë⁵⁷, nuk rezulton që ky shtetas të ketë qenë kallëzues, person nën hetim, i pandehur apo i dyshuar/kallëzuar në kallëzime/procedime penale të shqyrtuara nga prokurori Arben Dyla apo cilido prokuror i Prokurorisë së Rrethit Lushnjë, gjatë kohës që subjekti ka qenë drejtues i kësaj prokurorie⁵⁸ dhe as procedime penale⁵⁹ të regjistruara në emër të tij. Ndërsa, nga informacioni i marrë nga Prokuroria e Përgjithshme⁶⁰ rezulton se për shtetasin B. M. është regjistruar procedimi penal nr. ***, pushuar me vendimin e datës 19.6.2010 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, trajtuar nga prokurorja T. Rr. dhe kallëzim penal nr. ***, për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, në Prokurorinë Rrethit e Tiranë, trajtuar nga prokurori R. K., për të cilën është

⁵²Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.6.2021, nga ASHK-ja Kavajë në dosjen e Komisionit.

⁵³Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.5.2020, nga FSHU-ja në dosjen e Komisionit.

⁵⁴Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.6.2021, nga FSHU-ja në dosjen e Komisionit.

⁵⁵Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** port., datë 11.5.2021, nga Prokuroria e Rrethit Elbasan në dosjen e Komisionit

⁵⁶Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 7.5.2021, në dosjen e Komisionit.

⁵⁷Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në dosjen e Komisionit.

⁵⁸Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 15.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

⁵⁹Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

⁶⁰Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.6.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme në dosjen e Komisionit.

vendosur mosfillimi i procedimit penal. Pra, shtetasi B. M. ka qenë i proceduar penalisht, por jo nga subjekti i rivlerësimit.

62.6. Në lidhje me shtetasin F. M., pas verifikimeve të kryera në drejtim të konfliktit të interesit nuk rezultuan çështje të trajtuara nga cilido prokuror i Prokurorisë së rrethit Lushnjë gjatë kohës që subjekti Arben Dyla ka qenë drejtues i kësaj prokurorie⁶¹.

62.7. Në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë nga shtetasi F. M., ASHK-ja Kavajë⁶² informoi se origjina e pasurisë me nr. ***, z. k. ***, e llojit apartament me sip. 84.8 m², vjen nga regjistrimi i lejes së ndërtimit ***, datë 25.11.2002 (pallat 7 kate +bodrum) në emër të shoqërisë "Sh." sh.p.k. Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.8.2006, kjo pasuri i është shitur shtetasit F. M. në çmimin 17,000 euro. Ndërsa me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 14.4.2017, kjo pasuri i është shitur shtetasit R. K. në çmimin 3,000,000 leke.

62.8. I pyetur në lidhje me shpenzimet e mobilimit, subjekti informoi se⁶³ nga momenti që ka shkuar për të banuar në apartamentin e tij ka shpenzuar për mobilim vlerën e 25,000 lekëve për blerje frigoriferi, vlerën 60,000 lekë për kuzhinën e gatimit, si dhe dy divanë me vlerë prej 22,000 lekësh, ndërsa dhoma e gjumit ka qenë pajë e sjellë nga bashkëshortja, kurse tavolina me 5 karrige i ishte dhuruar nga prindërit. Duke qenë se subjekti ka filluar të banojë në këtë apartament në mesin e vitit 2012, shpenzimet e mobilimit në total në vlerën prej 107,000 lekësh, janë përfshirë në analizën financiare të këtij viti, e cila ka rezultuar me një balancë pozitive.

63. Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me këtë pasuri, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë sqarime dhe prova në lidhje me konstatimet si vijojnë:

- subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e kësaj banese në DPV-të për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar;
- mbeten të paqarta arsyet e përdorimit të kësaj pasurie për pesë vjet dhe pa kundërshtpërblim nga subjekti, për më tepër, në pronësi të një shtetasi, i cili ka qenë vëllai i të njohurit të subjektit, z. B. M., si dhe fakti nëse shtetasi F. M. ka pasur të ardhura të ligjshme për të blerë këtë pasuri.

64. Qëndrimi i subjektit dhe vlerësimi i Komisionit

64.1. Se pari, në prapësimet e tij, subjekti ka pretenduar se deklarimin për herë të parë në lidhje me banimin në apartamentin e z. F. M. e ka bërë që në DPV-në e vitit 2012, shumë kohë më parë se të niste procesi i rivlerësimit. Është e vërtetë që në DPV-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar si adresë banimi, *Lagjja nr. ***, Kavajë*, por nuk e ka deklaruar përdorimin e banesës në pronësi të shtetasit F. M.. Po kështu, gjatë hetimit, nuk u vërtetua që kjo banesë ndodhej në lagjen nr. ***, Kavajë.

64.2. Së dyti, sipas subjektit, konstatimi i Komisionit për mosdeklarimin e kësaj banese nuk qëndron pasi në të gjitha DPV-të për vitet 2013 – 2016, kjo adresë është vendosur si adresë banimi, përkundër sa deklaroi subjekti, kjo adresë është deklaruar si adresë vendbanimi vetëm në DPV-në 2012.

⁶¹Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 31.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 28.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 15.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në dosjen e Komisionit.

⁶²Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.6.2021, nga ASHK-ja Kavajë në dosjen e Komisionit.

⁶³Shihni përgjigjet e subjektit dërguar në rrugë elektronike në datën 21.6.2021, në dosjen e Komisionit.

64.3. Së treti, sa i takon të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie nga z. F. M., subjekti nga njëra anë pretendoi se nuk mund të marrë të dhëna mbi të ardhurat e përfituara të shtetasit F. M. për shkak të parashikimeve ligjore të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nga ana tjetër deklaroi se Komisioni nuk ka hetuar në këtë drejtim duke mos e konsideruar person tjetër të lidhur.

64.4. Përkundër sa pretendon subjekti (edhe në seancë dëgjimore), në rezultatet e hetimit administrativ, faqe. 17, pika 1.3, paragrafi i fundit, është shkruar “*referuar pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4, të nenit 32 të ligjit, shtetasi F. M., i cili ka dhënë në huapërdorje subjektit një apartament banimi për një afat prej pesë vjetësh gjate periudhës së rivlerësimit, është vlerësuar si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit*”. Po kështu, përkundër nga sa pretendon subjekti, nga Komisionit janë kryer disa veprime hetimore të kryera në lidhje me personin tjetër të lidhur, z. F. M., renditur në faqen 17 - 19 të rezultateve të hetimit dhe në përfundim të hetimit administrativ, është çmuar që subjektit t’i kërkohen sqarime dhe dokumente në ushtrim të barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të qartësuar nëse shtetasi F. M. ka pasur të ardhura të ligjshme për të blerë këtë pasuri ashtu sikurse neni 32/4 i ligjit nr. 84/2016 e kërkon. Në ushtrim të kësaj të drejte, subjekti nuk ka dhënë asnjë sqarim dhe nuk ka paraqitur ndonjë dokument shkresor, duke deklaruar se nuk mund të marrë të dhëna për të ardhura të këtij shtetasi, ndërkohe që nuk ka vërtetuar ndonjë interesim a përpjekje të tij për të marrë informacion në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë nga huadhënësi F. M..

65. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, përtej çdo dyshimi, nuk u evidentuan prova direkte që pasuria objekt shqyrtimi është një pasuri e fshehur në pronësi të subjektit të rivlerësimit, si dhe Komisioni nuk e gjeti subjektin në kushtet e konfliktit të interesit me vëllezërit M.. Por, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, çmoi të vlerësoje rrethanat e poshtëshënuara në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

- Për Komisionin mbeten të paqarta shkaqet dhe rrethanat në të cilat shtetasi F. M. ka lejuar përdorimin e pasurisë së tij nga subjekti me të cilin nuk ka pasur marrëdhënie, pa shpërblim për një periudhë 5-vjeçare, për shkak se ky shtetas ishte në gjendje të mirë ekonomike dhe nuk kishte nevojë për të ardhurat që mund të siguronte nga qiradhënia apo shitja (!!!), pretendim që, gjithsesi, mbetet në nivel deklarativ, pasi subjekti nuk paraqiti asnjë dokument që vërteton të ardhura të këtij shtetasi.

- Në ushtrim të barrës së provës, subjekti nuk paraqiti asnjë shpjegim a dokument shkresor për të qartësuar dhe vërtetuar mundësinë e shtetasit F. M. për të blerë me të ardhura të ligjshme pasurinë në çmimin 17.000 euro⁶⁴.

- Në DPV-në për vitin 2012, subjekti ka deklaruar adresë vendbanimi me përshkrimin “*Kavajë, Lagjja nr. ****”, pa deklaruar që kjo adresë i përket apartamentit të banimit të shtetasit F. M.. Ky fakt nuk u vërtetua as gjatë hetimit administrativ, ndërkohe që subjekti nuk dha sqarime të mëtejshme.

- Subjekti nuk e ka deklaruar në DPV për vitet 2013 –2016, këtë adresë, qoftë si adresë vendbanimi, qoftë si marrëdhënie interesi, sipas formularit “*Deklaratë e interesave private periodik/vjetor*” në rubrikat “*Adresës së vendqëndrimit tjetër*” apo “*Të dhëna konfidenciale në lidhje me persona fizikë e*

⁶⁴Kjo shumë nuk është konsideruar si shpenzim i tij në analizën financiare të subjektit.

juridikë që rezultojnë të lidhur me zyrtarin që mbart detyrimin për deklaram”, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, duke qenë në kushtet e pasaktësisë në deklarime.

66. Në DPV-në e vitit 2016, si dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si adresë të regjistrimit në Gjendjen Civile, adresën: “*Lagja ‘K. Q.’, Lushnjë*”. Në këtë periudhë subjekti ka qenë me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor, Lushnjë.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka sqaruar se: “...adresa tek lagjia ‘K. Q.’ Lushnjë’ është lapsus nga ana ime, pasi në këtë lagje banojnë vjehrrri dhe vjehrra ime shtetasit Gj. V. F. e L. Th. F.”, duke paraqitur⁶⁵ kopje të kartelës së pasurisë së banesës në emër të këtyre shtetasve. Gjithashtu, me kërkesën e Komisionit, referuar të dhënave të RNSh-së⁶⁶, noteri D. H., vuri në dispozicion⁶⁷ kontratë shitblerje nr. ***, datë 10.4.2018, sipas së cilës shtetasit Gj. F. dhe L. F. (vjehrrri dhe vjehrra e subjektit), kanë blerë nga shoqëria “M.” sh.p.k., apartamentin me sip. 60 m², të ndodhur në S., Tiranë, me çmim 20,000 euro. Në këtë kontratë, këta shtetas kanë deklaruar si adresë banimi, agjia “K. Q.” ***, Lushnjë. Pra, adresa e prindërve të bashkëshortes së subjektit Arben Dyla, “lagjia ‘K. Q.’, Lushnjë” përputhet me adresën e deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting*, si adresë të regjistrimit në Gjendjen Civile dhe me të dhënat e kartelës së pasurisë.

Deklarimi i subjektit, sipas të cilit shënimi i adresës lagjia “K. Q.” Lushnjë, ka qenë një lapsus, pasi në të vërtetë ka dashur të shkruajë adresën lagjia “Xh. N.”, Lushnjë, nuk e bindi trupin gjykues, pasi rezulton që vetëm në DPV-në 2012-2013, subjekti ka deklaruar adresën e Gjendjes Civile “lagjia ‘Xh. N.’, Lushnjë”. Pas këtij viti nuk ka të dhëna dhe as deklarime nga subjekti për regjistrimin në këtë adresë. Ndërsa, në DPV-në për vitin 2016 dhe në deklaratën *Vetting* deklarohet adresë e regjistrimit lagjia “K. Q.”, Lushnjë. Për këto arsye, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të vijojë të japë sqarime dhe prova që mund të hedhin dritë mbi paqartësitë e deklaramit të kësaj adrese si adresë e regjistrimit të Gjendjen Civile në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting*, si dhe adresën e regjistrimit në Gjendjen Civile pas vitit 2013 dhe aktualisht. Në parashtrimet e tij dhe as në seancën dëgjimore, subjekti nuk ka dhënë sqarime të mtejshme, duke e lënë situatën të paqartë dhe ky fakt u vlerësua nga Komisioni si një mangësi për t’u mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit.

67. Nga informacioni i administruar nga FSHU-ja⁶⁸ rezultoi se për shtetasin B. D. (babai i subjektit) është informuar se ka dy kontrata furnizim me energji, përkatësisht: (a) kontratë nr. ***, për instancën Durrës, Kavajë, kategoria familjar; (b) kontratë nr. *** për instancën Durrës - kategoria privat.

Subjekti, i pyetur nëse këto kontrata i përkasin babait të tij, ka sqaruar se vetëm kontrata *** për instancën Durrës, Kavajë, kategoria familjar, i përket babait të tij, duke paraqitur kopje të librezës së energjisë elektrike me nr. ***, në emër të babait B. D., librezës së ujit dhe dokumentet e pronësisë së banesës së babait me nr. pasurie ***, apartament me sip. 77 m². Ndërsa sa i takon kontratës ***, subjekti ka paraqitur⁶⁹ shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 20.5.2021, nga OSSh-ja, sipas të

⁶⁵Shihni përgjigjet e subjektit dërguar në rrugë elektronike në datën 21.06.2021, në dosjen e Komisionit.

⁶⁶Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.5.2020, nga Ministria e Drejtësisë në dosjen e Komisionit.

⁶⁷Shihni shkresë kthim përgjigje protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 12.6.2021, në dosjen e Komisionit.

⁶⁸Shihni shkresë nr. *** prot., datë 805.2020, nga FSHU-ja protokolluar në dosjen e Komisionit nr. *** prot., datë 11.5.2020.

⁶⁹Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, në dosjen e Komisionit.

cilës, me emrin B. D. rezultojnë 3 kontrata furnizimi me energji elektrike konkretisht: ***, ***, ***, ku vetëm kontrata *** i përket shtetasit B. H. D., që i përket pasurisë apartament me sip. 77 m², në bashkëpronësi të prindërve të subjektit, të ndodhur në lagjen nr. ***, Kavajë, kurse për dy kontratat e tjera *** dhe ***, rezultojnë në emër të abonentit B. Xh. D. me nr. identifikimi ***.

Në përfundim të hetimit administrativ, nuk rezultuan paqartësi të tjera në lidhje me këtë kontratë.

68. Në procesverbalin e datës 16.2.2016, pranë ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar se ka dhënë shumën 1,000 euro djalit të xhaxhait në Itali, nëpërmjet shërbimit “Western Union”, shumë e cila i është kthyer dorazi. Këtë deklaratë subjekti e ka bërë në kuadër të sqarimit të gjendjes së likuiditeteve.

I pyetur nga Komisioni, mbi periudhën se kur i është dërguar kjo shumë djalit të xhaxhait dhe kur i është kthyer prej tij, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar⁷⁰ se nuk i kujtohet koha e saktë se kur i është dërguar kjo shumë djalit të xhaxhait në Itali, por ka informuar se kjo shumë i është kthyer dorazi pas 2-3muajsh dhe duke qenë se kjo shumë i është kthyer brenda vitit të deklarimit, nuk është deklaruar si huadhënie, ndërkohë që deklararon se nuk ka asnjë dokumentacion provues për këtë transaksion. Meqenëse shumta është dhënë dhe kthyer brenda vitit ajo nuk afekton analizën financiare, kështu që nuk është përfshirë në të.

69. Nga të dhënat e sistemit *TIMS* rezulton se subjekti dhe familja e tij kanë udhëtuar, midis të tjerash, me automjetet me targat si vijojnë: AC ***; AA *** dhe AA ***.

I pyetur mbi pronarët e automjeteve, marrëdhëniet me ta dhe qëllimin e udhëtimeve, subjekti ka deklaruar se automjeti me targa AC *** është taksi me të cilën ka bërë udhëtimin Shkup-Qafë Thanë dhe drejtuesin e taksisë nuk e njeh. Nga verifikimi në AMF, referuar të dhënave të policëmbajtësit ky automjet rezultoi me përdorues I. M., për të cilin nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi apo procedime penale.

Ndërsa automjetet me targat AA *** dhe AA ***, i përkasin shtetasit S. K.. Me këtë automjet sqaron se ka qenë 2 herë në Maqedoninë e Veriut për pushime në Mavrovë. Nga verifikimi në AMF, referuar të dhënave të policëmbajtësit, këto automjete rezultuan me pronar shtetasin S. K., me të cilin nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi⁷¹.

70. Analiza financiare

Duke konsideruar si pasuri vlerën 50,000 euro e dhënë hua në vitin 2016, si dhe duke marrë parasysh disa prapësime të subjektit, sikurse është trajtuar edhe më lart në këtë vendim, sipas analizës financiare të rishikuar për të gjithë periudhën e rivlerësimit, pasqyruar në tabelën më poshtë, pamundësia totale financiare e subjektit është në shumën 5,540,462 lekë.

⁷⁰Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

⁷¹Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 31.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 28.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat në dosjen e Komisionit.

0	1	2	3	4
Përshkrimi	Pasuri	Të ardhura	Shpenzime	Mundësia për kursime (2-1-3)
2003	450 000	1 834 028	711 746	672 282
2004	306 640	1 329 874	103 964	919 270
2005	505 608	1 301 018	169 038	626 372
2006	138 043	1 218 832	124 557	956 232
2007	280 425	1 259 178	287 121	691 632
2008	-368 574	855 157	237 744	985 987
2009	291 742	1 269 256	556 016	421 497
2010	604 917	1 338 309	586 375	147 018
2011	499 151	1 500 551	619 101	382 299
2012	15 673	1 541 215	1 022 163	503 380
2013	-39 041	1 518 612	652 647	905 005
2014	480 179	1 725 434	1 132 447	112 807
2015	109 231	1 891 830	1 169 762	612 837
2016	5 531 816	1 500 032	1 508 677	-5 540 462

Metodologjia e përdorur gjatë analizës financiare

Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

Të ardhurat

- Të ardhurat nga punësimi të dokumentuara të subjektit përfshirë: pagat e subjektit nga data e emërimit në detyrë⁷² më 16.3.2001 dhe deri në fund të periudhës së vlerësimit. Të ardhura e bashkëshortes së subjektit nga viti 2009 deri në fund të periudhës së rivlerësimit⁷³.
- Të ardhura të tjera: të ardhura nga interesa bankare⁷⁴ për vitin 2016 dhe shuma e dhuruar për lindjen e fëmijës⁷⁵.

Shpenzimet

-Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas përbërjes familjare, duke u bazuar në standardin e ILDKPKI-së; nga fillimi i detyrës në mars të vitit 2001 janë përlllogaritur për 3 persona, pasi subjekti ka qenë në një trung familjar me prindërit e tij; nga viti 2003 deri në fund të vitit 2008 shpenzimet janë përlllogaritur për një person pasi subjekti ka jetuar më vete; nga janari i vitit 2009 dhe në vijim janë përlllogaritur për 3 persona (subjekti, bashkëshortja dhe fëmija i tyre).

⁷²Vërtetim nr. ***, datë 20.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, për periudhën 16.3.2001 – 10.6.2008; vërtetim, datë 13.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për periudhën 10.6.2008 – 31.12.2016, të administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷³Vërtetim nga Zyra Arsimore Lushnjë, për periudhën nga gusht 2009 – 31.12.2016; vërtetim nr. *** prot., datë 16.1.2017, nga ISSh-ja, Drejtoria Rajonale Fier, për pagesën gjatë lejes së lindjes nga 15.2.2016 – 24.1.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁴Shkresë nr. *** prot., datë 4.5.2020, nga “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

⁷⁵Deklaruar nga subjekti në DPV/2009, rubrika “Të ardhurat”.

-Shpenzimet e udhëtimit janë bazuar në raportin e sistemit *TIMS* dhe sqarimeve të dhëna nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ. Metodologjia e përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

- Shpenzimet për shkollën e fëmijës, për vitet 2015 dhe 2016⁷⁶.

- Shpenzimet e mobilimit janë përfshirë sikurse deklaruar nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit⁷⁷.

- Pagesa e zhdoganimit të automjetit në vitin 2012.

- Shpenzimet e transportit nga vendbanimi në vendin e punës janë bazuar në deklaratimet e subjektit⁷⁸, i cili ka sqaruar se ka udhëtuar kryesisht me automjete, të prokurorisë dhe personale, duke përcaktuar edhe shumën e shpenzimeve vjetore për transport. Kështu, këto shpenzime janë konsideruar si vijon: për periudhën mars 2001 – maj 2002, kur subjekti nuk ka specifikuar në çfarë mënyre ka udhëtuar është konsideruar çmimi i biletës së transportit publik Kavajë-Burrel-Kavajë, në vlerën 600 lekë dhe 2 udhëtime në javë sikurse ka deklaruar; për periudhën maj 2002 – maj 2008 janë konsideruar shumatat e deklaruara si të shpenzuara nga subjekti për çdo vit, pasi ka udhëtuar me automjetin e Prokurorisë së Rrethit Mat; për periudhën qershor 2008 – dhjetor 2016, shpenzimet e transportit janë përlllogaritur nga Komisioni duke konsideruar një muaj me 22 ditë pune, koha e punës 11 muaj (përveç muajit gusht), çmimi përkatës i karburantit për çdo vit, distancën Kavajë-Lushnjë-Kavajë dhe harxhimin e karburantit të një makine mesatare që është 7 litra/100 km.

Pasuritë

- Janë përfshirë dy makinat në pronësi të subjektit blerë përkatësisht në vitet 2006 dhe 2011.

- Likuiditeti i dhënë hua në vitin 2016.

- Gjendjet e llogarive bankare⁷⁹ në fund të çdo viti/date të analizuar dhe gjendjet *cash*, sikurse janë deklaruar nga subjekti në DPV-të dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit.

- Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për çdo vit.

- Vlera e çdo pasurie është marrë nga kontratat e porosive, shitblerjeve, deklaratat noteriale, si dhe çdo provë tjetër e administruar nga Komisioni, e ballafaquar me deklaratën Vetting dhe DPV-të.

- Shuma në fund, përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti nga fillimi i detyrës deri në fund të periudhës së vlerësimit.

Rezultati financiar është i përlllogaritur për çdo vit, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total. Mundësia për kursime rezulton si shumatore e të ardhura – shpenzime – pasuri, për çdo vit dhe për të gjithë periudhën e rivlerësimit.

⁷⁶ Marrëveshje me shkollën “T. O.” dhe mandatpagesat e paraqitura nga subjekti, me përgjigjet e pyetësorit standard.

⁷⁷ Sipas përgjigjeve të subjektit në pyetësorin standard dhe në pyetësorin nr. 2.

⁷⁸ Përgjigja e pyetjes nr. 11, në pyetësorin nr. 2.

⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.5.2020, nga “Raiffeisen Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 22.9.2020, nga “Credins Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 13.5.2020, nga “Union Bank”.

71. Vlerësimi përfundimtar në lidhje me kriterin pasuror

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë u vërtetua se subjekti i rivlerësimit Arben Dyla:

- i) ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin (germa “a”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016);
- ii) ka dyshime të arsyeshme që kontrata e huas nr. ***, datë 21.12.2016, është një kontratë fiktive, pasi nuk ka pasur si qëllim dhënien e huas prej 50.000 euro, por përfitimin e apartamentit të vënë si garanci;
- ii) ka mungesë të burimesh të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, për shkak balancës negative në shumën 5,540,462 lekë (germa “d”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016).

Për sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet pikës 5, të nenit 33, të këtij ligji, që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për këtë arsye, në përfundim nuk u pranua kërkesa e subjektit për riçeljen e hetimit administrativ për dy kriteret e tjerë.

IV. SEANCA DËGJIMORE

Në datën 7.9.2021, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Arben Dyla. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e tij, duke dhënë sqarime të mëtejshme mbi rezultatet e hetimit administrativ, procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, si dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues. Në datën 9.9.2021 u zhvillua seanca në të cilën Komisioni shpalli vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Dyla.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në komunikimet e tij, lidhur me dërgimin e shpjegimeve dhe dokumenteve të kërkuara, zoti Dyla ka qenë bashkëpunues me Komisionin dhe i gatshëm në kthimin e përgjigjeve, por, është konstatuar se me perfunimin e hetimit administrativ, subjekti kërkoi shtyrje të afatit të paraqitjes së parashtrimeve mbi rezultatet e hetimit për shkaqe jo tërësisht të justifikuar, si dhe shtyrje të datës së seancës dëgjimore të caktuar nga Komisioni. Pavarësisht se Komisioni i ka pranuar kërkesat e subjektit, ka vlerësuar se ato më së shumti janë paraqitur në limit të afatit të përcaktuar për paraqitjen e parashtrimeve apo datës së seancës dëgjimore, duke sjellë vonesa të cilat duhet të shmangen nga subjektet e rivlerësimit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë bisedimeve për vlerësimin përfundimtar të çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit si dhe në qëndrimin e subjektit të rivlerësimit për çdo çështje, rast pas rasti, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Arben Dyla,

nuk arin nivelin kualifikues për sa i takon kriterit të pasurisë, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Vendimmarrja për këtë subjekt u vlerësua të bazohet vetëm në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e pasurisë dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Dyla, prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore 64 dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 9.9.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi

